



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.142

21 tetor

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr.43, datë 6.10.2011	Me objekt: 1. Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës, i ndryshuar” 2. Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në përfundim të shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese.....	6395
Vendim i GJK nr.45, datë 10.10.2011	Me objekt: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.190, datë 18.4.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vendimit nr.389, datë 23.10.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimit nr.00-2009-449 (736), datë 18.12.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).....	6403
Vendim i GJL nr.4, datë 30.5.2011	Me objekt: Shfuqizimi i aktit administrativ “Njoftim-vlerësimi” për detyrimet nr.23702/5 prot., datë 26.11.2009. Shfuqizimi i vendimit nr.1113, datë 10.03.2010, i Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.	6408
Vendim i BSH nr. 62, datë 14.9.2011	Për miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”.....	6417
Vendim i BSH nr.63, datë 14.9.2011	Për disa ndryshime në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.....	6430

VENDIM
Nr.43, datë 6.10.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datat 1.3.2011 dhe 23.3.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 2, 7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve “Pronësi me drejtësi”, përfaqësuar nga avokatët Agim Tartari dhe Spiro Dodbiba, me prokurë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuar nga Njazi Jaho dhe Etilda Gjonaj, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, Enkelejd Alibeaj.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga Oltion Toro, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar.

2. Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në përfundim të shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 4/1, 7, 15, 17, 41, 42/1, 131/a, 134/1/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 45, 49/2, 50, 52/2 të ligjit 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe neni 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, përfaqësuesit e kërkuësve që kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e palëve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, Avokaturës së Shtetit dhe deputetin Enkelejd Alibeaj, që kërkuar rrëzimin e kërkesave dhe, pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës, i ndryshuar”. Ky ligj u hartua në plotësim të boshllëkut ligjor të krijuar pas shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese të neneve 15, pikat “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar me ligjin nr.10 207, datë 23.12.2009, u miratua nga Kuvendi, pas rrëzimit të dekretit 6664, datë 13.8.2010 të Presidentit të Republikës, dekret me të cilin ligji ishte kthyer për rishqyrtim në organin ligjvënës, pasi ishte vlerësuar se binte ndesh me disa parime kushtetuese.

2. Ligji nr.10308, midis të tjerash, parashikon kompetencën e Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (AKKP), që mbi bazën e një kërkesë për rishikim të paraqitur nga subjektet e përcaktuara shprehimisht në të, të shqyrtojë vendimet e ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qark, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve. Ligji parashikon, gjithashtu, shkaqet/rrethanat që justifikojnë paraqitjen e kërkesës për rishikim, subjektet që mund të kërkojnë rishikimin, afatin për paraqitjen e kërkesës për rishikim, procedurat për shqyrtimin në themel të kërkesës dhe vendimmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së.

3. Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve “Pronësi me drejtësi” (SHKSH) dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) i janë drejtuar, veçmas, Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar shfuqizimin e ligjit objekt kundërshtimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta) dhe Konventën europiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ), si dhe pezullimin e zbatimit të këtij ligji deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në datën 28.2.2011, bazuar në nenin 1, pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje dhe me nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), vendosi bashkimin e shqyrtimit të çështjeve të paraqitura nga kërkuesit, për shkak të objektit të njëjtë.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në datën 28.2.2011, shqyrtoi kërkesën paraprake të deputetit Enkelejd Alibeaj për t’u legjitimuar si subjekt i interesuar në këtë gjykim. Në vështrim të nenit 39/1/b të ligjit “Për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vlerësoi se ushtrimi i iniciativës ligjvënëse nga ana e deputetit, sipas nenit 81 paragrafi 1 të Kushtetutës për ligjin objekt kundërshtimi, justifikon interesin e drejtpërdrejtë dhe e legjitimoi atë si subjekt të interesuar në interes të gjykimit kushtetues.

II

A. *Kërkuesi, SHKSH*, në kërkesën e paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 6.12.2010, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

4. Ligji nr.10 308 cenon parimin e sigurisë juridike, pasi cenon të drejtat e fituara ligjrisht. Vendimet e KKKP-ve janë të barasvlershme me vendimet gjyqësore, të cilat, në rast se nuk janë ankimuar brenda afateve ligjore, marrin formë të prerë, fakt ky që nuk justifikon kërkesën për rishikim.

5. Nenet 16/1 - 16/7, që bëjnë fjalë për rishikimin administrativ të akteve të nxjerra nga ish-zyrat rajonale të AKKP-së, ish-komisionet për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe nga ish-komisionet e rretheve apo bashkive për kthimin dhe kompensimin e pronave vijnë në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve, pasi rishikimi i veprimeve dhe i akteve administrative është atribut vetëm i pushtetit gjyqësor dhe nuk mund të kryhet nga organet administrative (nenet 1, 324-333 të KPC-së).

B. *Kërkuesi, KSHH*, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në datën 2.2.2011, ka kërkuar shfuqizimin e ligjit objekt shqyrtimi si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, mbështetur në këto argumente:

6. Cenohet parimi i sigurisë juridike, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, pasi parashikon të drejtën e rishikimit të vendimeve të AKKP-së, të cilat ashtu si vendimet gjyqësore, nëse nuk janë ankimuar brenda afateve ligjore, marrin formë të prerë.

7. Cenohet parimi i ndarjes së pushteteve, parashikuar në nenin 7 dhe 135 të Kushtetutës, pasi ligji autorizon AKKP-në të shqyrtojë apo rishqyrtojë çështje që mund të ishin objekt shqyrtimi vetëm nga gjykatat e sistemit të zakonshëm. Në kuptim të nenit 141/1 të Kushtetutës dhe dispozitave të KPC-së, të drejtën e rishikimit të çështjeve në rrugë gjyqësore e ka vetëm Gjykata e Lartë.

8. Kompetenca e drejtorit të AKKP-së për rishikimin e vendimeve përfundimtare të ish-KKKP-ve, bie ndesh me nenin 42 të Kushtetutës, sepse nuk kemi të bëjmë me interes publik, por me një të drejtë subjektive dhe, për rrjedhojë, shqyrtimi i të drejtës së pronësisë nuk mund të bëhet nga një organ administrativ në varësi të pushtetit ekzekutiv (Këshillit të Ministrave), por vetëm nga

gjykatat e sistemit të zakonshëm. Ligji, objekt kundërshtimi, përbën në vetvete një kufizim të së drejtës së pronës, që cenon thelbin e vetë të drejtës, pa pasur interes publik dhe as në mbrojtje të të drejtave të të tjerëve ose në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar (neni 17/2).

III

A. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur:

i) Në lidhje me legjitimitimin e kërkesve:

9. KSHH nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi: nuk paraqitet ndonjë fakt ose rrethanë për të justifikuar pretendimin e KSHH-së se gjatë zbatimit të këtij ligji ndaj individëve (në rastin më të justifikueshëm anëtarë të KSHH-së), por edhe individëve të tjerë, të jenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore; objekti i veprimtarisë së KSHH-së për përsosjen e legjislacionit vendas, sidomos dispozitave që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, nuk e legjitimon atë t'i drejtohet kësaj Gjykate, por thjesht t'u drejtohet subjekteve kushtetuese propozuese të projektligjeve, komisioneve parlamentare ose institucioneve të tjera, duke ju shprehur atyre opinione për projektligje apo ligje të caktuar; KSHH-ja nuk mund të barazohet me subjektet kushtetuese, të cilët kanë një prerogativë kushtetuese të pakushtëzuar për t'iu drejtuar kësaj Gjykate dhe nuk mund të ketë diskrecion më të gjerë se Avokati i Popullit, të cilit ligji organik dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese i ka dhënë mundësinë e paraqitjes së një kërkesë për shfuqizimin e një ligji, pas shqyrtimit nga ky institucion të kërkesave të individëve për shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese nga zbatimi i tij.

10. SHKSH nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk parashtron asnjë argument mbi të drejtën e kësaj shoqate për të ngritur pretendime për shfuqizimin e ligjit.

ii) Në lidhje me themelin e çështjes:

11. Pretendimi i kërkesve se ligji cenon parimin e sigurisë juridike, në vështrim të neneve 4, 41, 42 dhe 132 të Kushtetutës, është i pabazuar, pasi asnjë nga këto norma kushtetuese nuk ka qasje të drejtpërdrejtë me ligjin e miratuar nga Kuvendi. Ligji i referohet një numri të përcaktuar vendimesh të KKKP-ve, të cilat kanë shkelje ligjore dhe, si të tilla, duhen korrigjuar.

12. Përfshirja e institutit të rishikimit, si një mjet i përshtatshëm, i njohur dhe i perceptueshëm sipas rregullimeve të KPC-së, jo vetëm nuk bie ndesh me asnjë nen të Kushtetutës ose vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por është në koherencë të plotë me to.

iii) Në lidhje me kërkesën për pezullimin e ligjit:

13. Kërkesit nuk japin asnjë argument mbështetës për pezullimin e ligjit objekt kundërshtimi, i cili në të vërtetë nuk shkakton asnjë pasojë për interesat shtetërorë, shoqërorë apo interesave të ligjshëm të individëve dhe, për rrjedhojë, nuk ka vend marrja e masës së pezullimit.

B. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka parashtruar këto prapësime:

i) Në lidhje me legjitimitimin e kërkesve:

14. SHKSH-ja nuk parashtron në kërkesë asnjë argument për të provuar ekzistencën e interesit të drejtpërdrejtë në çështjen objekt gjykimi, interes i cili është cenuar si rezultat i zbatimit të normave të ligjit objekt kundërshtimi. Edhe baza kushtetuese e kërkesës, neni 134, pika "g" është referencë e gabuar.

15. Interesi i KSHH-së në çështjen objekt gjykimi nuk duhet parë i lidhur me objektin e veprimtarisë së kësaj shoqate, por me të drejtën e shkelur si pasojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike të kundërshtuar. Interesi i KSHH-së duhet të provohet rast pas rasti, duke evidentuar edhe masën e cenimit, pra dëmin real apo potencial.

ii) Në lidhje me themelin e çështjes:

16. Pretendimi i kërkesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe, për rrjedhojë, edhe të pritshmërive të ligjshme, është i pabazuar, pasi ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast dhe se interesi publik merr përparësi.

17. Është gjithashtu i pabazuar edhe pretendimi i kërkesve se ligji cenon parimin e ndarjes së pushteteve, pasi ligji e ndan juridiksionin gjyqësor nga ai rishikues i AKKP-së dhe nuk lë shteg për mbivendosje ose cenim të ndarjes së pushteteve, për faktin se vendimi i AKKP-së nuk përbën titull ekzekutiv pa ezaurimin e së drejtës së ankimit gjyqësor nga subjektet e interesuara.

18. Ligji respekton saktësisht dhe korrektësisht të gjitha konstatimet juridike të vendimit nr.27, datë 26.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim nuk ka përjashtuar në mënyrë kategorike mundësinë e rishikimit të vendimeve të ish-KKKP-ve.

19. Ligji nuk cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Çështjet e njohjes, të kthimit dhe të kompensimit të pronës janë trajtuar nga ligjvënësi si jashtë juridiksionit gjyqësor, por brenda fushës së veprimit të organeve administrative ose atyre *quasi* gjyqësore, pasi këto të fundit kanë të gjitha mundësitë ligjore dhe institucionale për hetimin dhe verifikimin e plotë administrativ gjatë procedurës për nxjerrjen e akteve administrative për pronësinë.

C. Subjekti i interesuar, deputeti Enkelejd Alibeaj ka prapësuar pretendimet e SHKSH-së, KSHH-së në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

20. Ligji i ri respekton parimin e sigurisë juridike si në aspektin formal, ashtu dhe në atë material. Procesi i rishikimit nuk cenon pritshmëritë e ligjshme të qytetarëve, të cilat në një shtet ligjor mbrojnë të drejtat e ligjshme dhe jo ato të paligjshme.

21. Gjithashtu, ligji kërkon ekzistencën e shkaqeve dhe arsyeve objektive, të parashikuara në mënyrë shteruese në të, për fillimin e procesit të rishikimit, duke shmangur mundësinë e kërkimit të rishikimit bazuar thjesht në pakënaqësitë mbi përmbajtjen e vendimit. Parashikimi nga ligji i mundësisë së rishikimit me anë të një kërkesë nga subjektet e parashikuara nga ligji dhe jo kryesisht nga drejtori i AKKP-së, detajimi i rregullave, procedurave dhe afateve të qarta për rishikimin, eviton çdo premisë për arbitraritet.

22. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar:

23. Ligji parashikon kriteret objektive rishikimi dhe një procedurë që mishëron analogjinë me “gjënë e gjykuar”, si në rastin e vendimeve gjyqësore. Shkaqet e rishikimit janë të përligjura për situata shumë specifike dhe vetëm në raste thelbësore kundrejt arritjes së barrës së provës në mbështetje të kërkesës për rishikim nga kërkuesi.

24. Ligjvënësi, për rregullimin e disa situatave specifike të diktuar nga realiteti, ka ndjekur interesin publik duke synuar vënien e drejtësisë sociale, të cilën e ka balancuar me parashikimin e një procedure transparente.

IV

25. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) në datë 1.3.2011 shqyrtoi kërkesën për pezullimin e ligjit objekt kundërshtimi. Me qëllim parandalimin e pasojave të pariparueshme që mund t’u vijnë të drejtave dhe lirive themelore të individit, në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vendosi pezullimin e zbatimit të neneve 2, 3, 5 të ligjit nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235 datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar”, deri në dhënien e vendimit përfundimtar të saj.

Lidhur me legjitimitimin e kërkuesve

26. Gjykata, përpara se të marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesve dhe prapësimet përkatëse të subjekteve të interesuara, vlerëson të shprehet në lidhje me pretendimin e përfaqësuesve të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave se kërkuesit nuk legjitimohen të vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

27. Çështjen e legjitimitimit, Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në funksion të legjitimitimit *ratione personae*, Gjykata ka konsoliduar qëndrimin e saj lidhur me rrethin e subjekteve që përfshihen në “*organizata të tjera*” të parashikuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, duke përfshirë organizatat politike (neni 131, shkronja “d”), etnike, kulturore, fetare, gjuhësore (neni 20/2), sindikale (neni 50), shoqërore, ekonomike, tregtare (neni 61/4) dhe të tjera (neni 9/2). Pra, Kushtetuta e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë termit “organizatë” edhe për grupime me qëllime të tjera të organizimit të individëve, me kushtin që organizimi, programet dhe veprimtaria e tyre të përputhen me parimet demokratike të shtetit të së drejtës.

28. Gjithashtu, në vështrim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës, shoqatat (organizata të tjera) janë subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për të iniciuar gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në këtë kuptim, ato duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.3.2008; nr.17, datë 25.7.2008; nr.4, datë 12.2.2010; nr.9, datë 23.3.2010, nr.4, datë 23.2.2011*).

29. Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimet nr.16, datë 25.7.2008; nr.4, datë 23.2.2011*). Vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë patur një efekt çfarëdo mbi kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.31, datë 18.6.2010*).

30. Gjykata konstaton se SHKSH-ja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 26.10.2010, si person juridik – shoqatë. Sipas aktit të themelimit dhe statutit të datës 10.3.2010, SHKSH-ja është një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse, e cila synon mbrojtjen e të drejtave të pronarëve të shpronësuar padrejtësisht, mbrojtjen e të drejtës së pronësisë dhe zgjerimin e saj, si dhe përfaqëson interesat e pronarëve përpara shtetit dhe organizmave kombëtare dhe ndërkombëtare, nxit zhvillimin e të drejtës së pronësisë dhe merr pjesë aktive në përpunimin dhe përmirësimin e legjislacionit civil, ekonomik dhe financiar.

31. Gjykata konstaton se KSHH-ja është regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 19.7.2002 dhe sipas aktit të themelimit dhe statutit (neni 2, pika 4) është një organizatë jofitimprurëse, e cila, midis të tjerash, synon përsosjen e mëtejshme të legjislacionit vendas, sidomos të dispozitave që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve.

32. Kërkuesit pretendojnë shfuqizimin e ligjit nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin pronës”, i ndryshuar”, i cili ka për objekt rregullimin e çështjeve të pronësisë që kanë lindur si rezultat i shpronësimeve, shtetëzimeve ose konfiskimeve, autoritetet përgjegjëse për zbatimin e procedurave për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave, kompetencat e tyre, si dhe afatet ligjore për plotësimin e këtij detyrimi.

33. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se bazuar në statutin dhe aktin e themelimit të kërkuesve, provohet lidhja e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin ata janë krijuar dhe çështjes kushtetuese të pretenduar prej tyre dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat e ligjit, objekt shqyrtimi, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues, pasi provojnë dhe interesin e tyre për të vepruar i cili është i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak, dhe për rrjedhojë pretendimi i përfaqësuesve të subjekteve të interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, është i pabazuar.

VI

Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e pronës

34. Kërkuesit kanë pretenduar, midis të tjerash, se ligji i kundërshtuar cenon parimin e sigurisë juridike, duke arsyetuar se, në thelb, ky ligj cenon të drejtat e fituara ligjrisht.

35. Gjykata ka vlerësuar se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik, pa marrë për sipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesat dhe pritshmëritë ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi me masat për vënien e tyre në jetë duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.34, datë 20.12.2005; nr.9, datë 26.2.2007; nr.4, datë 12.2.2010, nr.24, datë 12.11.2008; nr. 31, datë 18.6.2010*).

36. Gjykata, në referim edhe të jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka theksuar se siguria juridike presupozon respektimin e parimit të gjësë së gjykuar, që garanton se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rigjykimin e një çështjeje që është zgjidhur me vendim të formës së prerë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.27, datë 26.5.2010*). Përrjashtim nga ky rregull janë procedurat e parashikuara në Kodet e Procedurës Civile dhe të Procedurës Penale mbi rishikimin e vendimeve të formës së prerë.

37. Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, apo t'u përgjigjet prioritetëve apo problemeve të ndryshme të vendit. Megjithatë, ligjet apo dispozitatë të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me normat e Kushtetutës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.29, datë 31.5.2010*).

38. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, Gjykata nisat nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se, lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar, duhet të parashtrihen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese. Në këtë kuptim roli dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese, është që në përputhje me parimin e proporcionalitetit të verifikojë nëse mjeti i zgjedhur nga legjislatori është më i përshtatshmi për të garantuar sigurinë juridike për të drejtën themelore siç është e drejta e pronës.

39. Në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, Gjykata vlerëson paraprakisht nëse ligji i kundërshtuar ka shtuar kritere ose procedura të reja për zbatim nga AKKP-ja, të cilat vijnë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike.

40. Ligji objekt shqyrtimi, në nenin 3, parashikon kompetencën e organit administrativ të AKKP-së, për të vendosur në lidhje me rishikimin e vendimeve të mëparshme të komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave, kur pretendohet nga persona të tretë se janë cenuar në të drejtën e tyre, në rastet e mëposhtme:

“a) zbulohen rrethana të reja apo akte të reja shkresore që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen gjatë shqyrtimit të kërkesës për njohje, kthim apo kompensim të pronës;

b) vërtetohet se aktet shkresore, në bazë të të cilave është dhënë vendimi, të kenë qenë apo të jenë deklaruar më pas të pavërteta me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) vërtetohet se aktet shkresore, në bazë të të cilit është dhënë vendimi, të jenë lëshuar nga zyrtarë të dënuar penalisht për lëshimin e tyre;

d) vendimi përmban një gabim material në fakt ose në ligj, bazuar në faktet e administruara në dosje gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës për njohje, kthim apo kompensim të pronës;

e) zyrtarët që kanë marrë pjesë në dhënien e vendimit kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit;

f) vendimi është i bazuar në një vendim gjyqësor ose akt të një organi tjetër, që ka ndikuar në marrjen e vendimit, dhe që më pas është prishur/ndryshuar.”

41. Legjislacioni që rregullon procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, në të gjithë historikun e tij në Republikën e Shqipërisë, i ka njohur palëve private të drejtën e ankimit ndaj një vendimi të organit shtetëror, i cili refuzonte njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës si në rrugë administrative, ashtu edhe në rrugë gjyqësore. Nga ana tjetër, vendimet që njohin, kthejnë apo kompensojnë pronën në vite, të cilat kanë marrë formë të prerë si në rastet kur nuk janë ankimuar në formën dhe afatin që përcaktonte ligji i kohës, apo si pasojë e një vendimi gjyqësor përfundimtar, nuk mund të kenë pasoja për të tretët, pasi këta të fundit nuk kanë qenë palë në proces.

42. Gjykata ka theksuar se: Në kushtet kur një person vinte në lëvizje me kërkesë KKKP-në, kjo kërkesë ishte e barazvlefshme si të ishte bërë para gjykatës dhe vendimi i KKKP-së ishte në gjendje që të krijonte te individi të njëjtën pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor i cili njeh individit pronësinë mbi një send. Në këtë përfundim ka arritur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Viasu kundër Rumanisë; Ramadhi, apo Hamzaraj; kundër Shqipërisë*, duke barazuar vendimin e KKKP-së me një vendim gjyqësor i cili krijon pritshmërinë e ligjshme të individit se ose do të vihet në posedim të pronës ose do të dëmshpërblehet. (*shih vendim e Gjykatës Kushtetuese nr.27, datë 26.5.2010*).

43. Gjykata konstaton se neni 2 (që shton nenin 15, paragrafi i parë i shkronjës “b” të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të ndryshuar), neni 3 (që shton nenet 16/1; 16/2;16/3; 16/4; 16/5; 16/6 dhe 16/7 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”) dhe neni 5 përcaktojnë se çdo subjekt i shpronësuar, personat juridikë publikë që sipas ligjit të kohës nuk i nënshtroheshin njohjes, kthimit, kompensimit ose Avokatura e Shtetit, kur pretendojnë se ekzistojnë shkaqet e rishikimit sipas nenit 16/1, kanë të drejtë që brenda 45 ditëve nga marrja dijeni për shkakun e rishikimit (afat ky që për Avokaturën e Shtetit është jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka lindur shkakun e rishikimit, neni 16/4) të paraqesin kërkesë për rishikim në AKKP kundër vendimeve të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të ish KKKP-ve, si dhe ish komisioneve të rretheve dhe bashkive për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve. Ligji kërkon që vendimet për të cilat kërkohet rishikimi nuk duhet të jenë duke u shqyrtuar në themel në gjykatë, ose për to gjykata nuk ka dhënë një vendim të formës së prerë (neni 16/2). Me përfundimin e procedurave të rishikimit, Drejtori i AKKP-së, brenda afatit 60-ditor, vendos, sipas rastit, lënien në fuqi të vendimit të rishikuar, ose shfuqizimin e këtij vendimi, ose shfuqizimin dhe zgjidhjen në themel të çështjes (neni 16/7).

44. Drejtori i AKKP-së, midis të tjerash, shfuqizon vendimin e ish KKKP-ve, kompetencë kjo që në vendimin e mëparshëm të kësaj Gjykate, nr.27 datë 26.5.2010 për shfuqizimin e neneve 15 pika 1, geramat “c”, “ç”, “d”, “dh”, dhe nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar me ligjin nr.10 207, datë 23.12.2009, “Për disa ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar, është konsideruar se përbën cenim të parimit të sigurisë juridike, pasi zbatimi nga një organ administrativ si AKKP-ja, i parimeve të revokimit dhe shfuqizimit të akteve të ish-KKKP-ve, që nuk janë akte tipike administrative të një organi tipik administrativ, është vlerësuar ndërhyrje e pajustificuar mbi të drejtat civile të shtetasve.

45. Në vlerësimin e Gjykatës, aplikimi në ligj i procedurës për rishikim të vendimeve të ish-KKKP-ve, të cilat nuk janë duke u shqyrtuar në themel në gjykatë apo për të cilat gjykata nuk ka dhënë një vendim themeli të formës së prerë, çon në lindjen e një marrëdhënieje të re midis individëve, të cilëve e drejta e pronësisë u ishte njohur apo kthyer me vendim të formës së prerë të ish KKKP-ve, por që potencialisht mund të zhvishen nga titulli i pronësisë si rezultat i shfuqizimit të këtyre vendimeve nga drejtori i AKKP-së, nga njëra anë dhe të gjitha subjekteve të tjera, duke përfshirë edhe Shtetin, nga ana tjetër.

46. Në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se titujt e pronësisë të fituar me anë të këtyre vendimeve të ish KKKP-ve nuk mund të anulohen apo shfuqizohen *iure imperi*, pra në mënyrë të njëanshme, me anën e vendimeve administrative të nxjerra nga autoritetet publike përkatëse, në rastin konkret të drejtorit të AKKP-së. Ushtrimi i një kompetence të tillë shfuqizuese

krijon një gjendje pasigurie juridike, e cila nuk mund të korrigojë me zgjidhje që imponojnë veprime po aq të pasigurta, të cilat nuk garantojnë kthimin në ligjshmëri. Vendimet e ish KKKP-ve, nëse nuk janë ankmuar brenda afateve ligjore, janë vlerësuar si vendime të formës së prerë dhe, për rrjedhojë, të ekzekutueshëm dhe nuk mund të vihen në diskutim as nga palët që kanë marrë pjesë në proces, dhe as nga organet shtetërore, të çfarëdo natyre qofshin.

47. Si përfundim, Gjykata arrin në përfundimin se ligji, objekt kundërshtimi, cenon parimin e sigurisë juridike për të drejtën e pronës.

Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës

48. Kërkuar kanë pretenduar se ligji nr.10 308 cenon parimin e ndarjes së pushteteve, pasi ligji autorizon AKKP-në të shqyrtojë apo rishqyrtojë çështje që mund të ishin objekt shqyrtimi vetëm nga gjykatat e sistemit të zakonshëm. Në kuptim të nenit 141/1 të Kushtetutës dhe dispozitave të KPC-së, të drejtën e rishikimit të çështjeve në rrugë gjyqësore e ka vetëm Gjykata e Lartë.

49. Gjykata e vlerëson këtë pretendim në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Kjo e drejtë kushtetuese, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 4.4.2007*). E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit), nënkupton të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 11.5.2006*).

50. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka vlerësuar se në kuptim të nenit 135/1 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Ndërsa sipas nenit 36 të KPC-së, në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Në vlerësimin e Gjykatës kjo do të thotë se, në aspektin kushtetues e ligjor, pushteti për dhënien e drejtësisë, domethënë pushteti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, civile apo të tjera, u është dhënë gjykatave.

51. Gjykata konstaton se instituti i rishikimit, i sanksionuar nga ligji objekt kundërshtimi, parashikohet edhe nga normat procedurale civile dhe penale, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi (nenet 494 të KPC-së dhe 450 të KPP-së). Duke krahasuar përmbajtjen e nenit 16/1 të ligjit objekt kundërshtimi me atë të normave procedurale të mësipërme, Gjykata konstaton se ligjvënësi ka përfshirë në ligjin objekt kundërshtimi shkaqe/arsye të ngjashme për rishikimin e vendimeve të formës së prerë të ish KKKP-ve me ato të parashikuara nga dispozitat procedurale për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

52. Gjykata konstaton, gjithashtu, se ligji nr.10 308, datë 22.7.2010 i ka njohur drejtorit të AKKP-së kompetencën që, në përfundim të procedurave të rishikimit të vendimeve të formës së prerë të ish KKKP-ve mbi bazën e subjekteve të përcaktuara shprehimisht nga ligji, jo vetëm t'i shfuqizojë ato vendime, por, sipas rastit, të zgjidhë edhe çështjen në themel.

53. Në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata rithekson se drejtori i AKKP-së është një organ monokratik në vartësi të Këshillit të Ministrave, dhe jo organ gjyqësor ose *quasi* gjyqësor, i cili mund të zbatojë parimet e shfuqizimit ose rishikimit të akteve të ish-KKKP-ve. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se, ndryshe nga sa pretenduan subjektet e interesuara, statusi dhe parimet që zbaton ky organ, si aksesit, transparenca, vlerësimi objektiv i fakteve dhe provave, nuk i japin atij tiparet e organit *quasi* gjyqësor ose gjyqësor dhe as e legjitimojnë atë në ushtrimin e kompetencës gjyqësore të rishikimit të vendimeve të formës së prerë.

54. Gjykata vlerëson se Kushtetuta nuk e pengon një organ administrativ të njohë të drejtën e pronës së shtetasve, por për të kufizuar këtë të fundit përcakton si kushte interesin publik njëkohësisht dhe shpërblimin e drejtë (*neni 41 i Kushtetutës*). Ligji objekt kundërshtimi synon të

ndreqë paligjshmëritë në procesin e njohjes e kthimit dhe jo shpronësimin apo kufizime të të drejtës së pronësisë që barazohet me shpronësimin.

55. Gjykata vlerëson se prona si një e drejtë themelore e njohur me Kushtetutë, me ligj dhe me vendim të ish-KKKP-ve, nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor sipas përcaktimeve të nenit 42 të Kushtetutës. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se vendimet e formës së prerë të ish-KKKP-ve nuk mund të anulohen apo shfuqizohen nga organe administrative.

56. Në përfundim, Gjykata arrin në konkluzionin se nenet 2, 3 dhe 5 të ligjit objekt kundërshtimi bien ndesh me nenet 4, 41 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6/1 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 të saj dhe, si të tilla, duhen shfuqizuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a” e Kushtetutës, si dhe në nenet 45, 71 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të neneve 2, 3 dhe 5 të ligjit nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Petrit Ploçi.

Anëtarë kundër: Xheziar Zaganjori, Vitore Tusha, Admir Thanza.

VENDIM

Nr.45, datë 10.10.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datë 30.6.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.27 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ilir Sina, përfaqësuar nga avokat Idajet Beqiri, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.190, datë 18.4.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vendimit nr.389, datë 23.10.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimit nr.00-2009-449 (736), datë 18.12.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 33/1, 42, 131/f, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 i Konventës europiane të të drejtave të njeriut (KEDNJ); neni 1 i Protokollit nr.4 të KEDNJ-së; ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari është akuzuar për veprën penale të “mashtimit të kryer më shumë se një herë dhe që ka sjellë pasoja të rënda”, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.190, datë 18.4.2007, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Sina për veprën penale të “mashtimit të kryer më shumë se një herë” e që ka sjellë pasoja të rënda dhe në bazë të nenit 143/2 të Kodit Penal, e ka dënuar me 10 (dhjetë) vjet burgim.”*

3. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim përfaqësuesi me prokurë i kërkuarit.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.389, datë 23.10.2007, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr.190, datë 18.4.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.”*

5. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs nga përfaqësuesi me prokurë i kërkuarit.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, me vendim nr.00-2009-449 (736), datë 18.12.2009 ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.

7. **Kërkuari Ilir Sina** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve objekt kërkesë (edhe pse pretendimet e tij lidhen vetëm me vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Apelit Durrës), për arsye se janë marrë si rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur argumentet si më poshtë:

i) *Është cenuar e drejta e mbrojtjes e sanksionuar nga neni 31 i Kushtetutës dhe nga neni 6/3/c i KEDNJ-së*, pasi gjatë gjykimit të çështjes në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, kërkuari është gjykuar në mungesë, si rezultat i mosrespektimit të dispozitave procedurale penale për njoftimin e të pandehurit.

ii) Gjithashtu, si pasojë e gjykimit në mungesë të kërkuarit, *është cenuar e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata dhe për të marrë pjesë personalisht në gjykim, të sanksionuara nga neni 33 i Kushtetutës.*

iii) Vendimet e gjykatave të të dyja niveleve janë rrjedhojë e interpretimit të gabuar të fakteve dhe zbatimit të keq të ligjit material penal, pasi në rastin konkret ka munguar ana subjektive e veprës penale. Rrjedhimisht, kërkuari pretendon se gjendemi përpara një rrethane të përmbushjes së një detyrimi kontraktor civil dhe sipas nenit 1 të Protokollit 4 të KEDNJ-së, askujt nuk mund t'i hiqet liria për arsyen e vetme se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

II

A. Në lidhje me pretendimin e zhvillimit të gjykimit në mungesë

8. Kërkuari pretendon se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, atij i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si rrjedhojë e zhvillimit të gjykimit në mungesë të tij. Kërkuari pretendon se këto standarde kushtetuese janë cenuar, pasi gjykatat e të dyja niveleve nuk kanë respektuar rregullat për njoftimin e të pandehurit, të parashikuara në Kodin e 6404

Procedurës Penale. Në kuptim të këtyre standardeve, neni 31 i Kushtetutës përcakton se “Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij. ... ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; ...”. Ndërsa në nenin 33 të Kushtetutës përcaktohet se “Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë”.

9. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t’u mbrojtur në procesin gjyqësor, janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

10. Gjykata, duke iu referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), ka përcaktuar ndër vite disa standarde në lidhje me gjykimin në mungesë, sipas të cilave: a) i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm në procesin gjyqësor të kryer në ngarkim të tij; b) i pandehuri mund të heqë dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejte; c) i pandehuri duhet të jetë në dijeni për ekzistencën e një procesi gjyqësor në ngarkim të tij; ç) duhet të ekzistojnë instrumente paraprake ose riparuese për të shmangur procese në ngarkim të të pandehurit, ose për të siguruar një proces të ri dhe, nëpërmjet depozitimit të provave të reja, të drejtën e mbrojtjes që nuk ka qenë e mundur të ushtrohet personalisht në procesin e zhvilluar në mungesë, të përfunduar tashmë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.6.2010*).

11. Sipas praktikës së kësaj Gjykate, si dhe të GJEDNJ-së, është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve, sipas Gjykatës, është detyrë e organeve kompetente. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë, kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.6.2010*).

12. Gjykata, gjithashtu, është shprehur se duhet të pranohet mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit vetëm nëse provohet se ata po veprojnë në bazë të porosisë që kanë marrë nga i pandehuri. Pra, lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse ata nuk kanë kontakte me të pandehurin, çka është detyrë e organeve kompetente shtetërore. Në këtë mënyrë është rigoroz zbatimi i procedurave të njoftimit (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.6.2010*).

13. Si konkluzion, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri duhet të ketë dijeni nëse ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata ka arritur në këtë përfundim, për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar, duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.6.2010*).

14. Veç sa më sipër, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ka miratuar rezolutën (75) 11 “Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit”, duke u rekomanduar shteteve anëtare që të mbajnë parasysh 9 rregulla minimale: i) askush nuk duhet të gjykohet pa pasur një thirrje për gjyq në kohë; ii) kjo thirrje për gjyq duhet të ketë të sanksionuara edhe pasojat nëse i akuzuari nuk vjen në gjykim; iii) kur gjykata vëren se edhe pse i akuzuari është njoftuar dhe nuk është paraqitur, ajo, nëse çmon se prania e tij në proces është e pazëvendësueshme ose beson se i akuzuari është penguar të paraqitet, duhet të vendosë shtyrjen e procesit; iv) i akuzuari nuk duhet të gjykohet në mungesë, nëse është e mundur të transferohen procedimet te një shtet tjetër ose të aplikohet për ekstradim; v) kur i akuzuari gjykohet në mungesë, provat duhet të merren në mënyrë të zakonshme dhe mbrojtja duhet të ketë të drejtë të ndërhyjë; vi) një vendim gjykate, i dhënë në mungesë, duhet t’i njoftohet personit sipas rregullave për njoftimet dhe marrjes dijeni brenda afatit të parashikuar për apelim. Ky

afat duhet të fillojë që nga dita e marrjes dijani efektivisht të personit, përveçse kur ai qëllimisht i fshihet drejtësisë; vii) çdo personi të gjykuar në mungesë duhet t'i jepet e drejta për apelim, me çdo lloj mjete ligjor që do t'i ishte dhënë sikur ai të ishte i pranishëm; viii) për personin e gjykuar në mungesë, të cilit nuk i është bërë njoftimi në mënyrën e duhur, duhet të ketë një mjet ankimi që t'i mundësojë atij shfuqizimin e vendimit; ix) një person i gjykuar në mungesë, por që njoftimi i është bërë në rregull, duhet të ketë të drejtën e një rigjykimi në mënyrën e zakonshme, nëse ai mund të provojë mungesën e tij para gjykatës për arsye të pavarura nga vullneti i tij.

15. Duke u bazuar në këto parime, edhe GJEDNJ-ja ka përcaktuar kritere të qarta dhe të plota për drejtësinë kushtetuese lidhur me gjykimin në mungesë. Ajo ka theksuar se e drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë (*Ektabani kundër Suedisë, 1988; Vaundelle kundër Francës, 2003*). Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet kanë natyrë kontradiktore. Shteti ka detyrimin për t'i dhënë të pandehurit një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij (*Poitrimol kundër Francës, 1993; Spinatto kundër HMP Brixton dhe Italisë, 2001*). Gjykata thekson se është e një rëndësie thelbësore që i akuzuari të jetë i pranishëm në seancë, sepse ai ka të drejtën të dëgjohet, por edhe sepse ai ka nevojë t'i verifikojë gjykatës vërtetësinë e thënieve të tij dhe t'i krahasojë këto me të palës tjetër ose dhe të dëshmitarëve. Ligjvënësi duhet të jetë në gjendje të mos nxisë mungesa të pajustificueshme (*Geysseghem kundër Belgjikës, 1999*). Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*Mariani kundër Francës, 2005*).

16. GJEDNJ-ja është shprehur gjithashtu se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjafton. Ndërkohë, nëse mund të pranohet një njoftim edhe tërthorazi, heqja dorë duhet të jetë e qartë. Është një e drejtë e personit të dënuar *in absentia*, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat (*Sejdovic kundër Italisë, 2000*).

17. KEDNJ-ja u lë shteteve kontraktuese një diskrecion të gjerë lidhur me zgjedhjet e mjeteve, për të siguruar se sistemi i tyre ligjor është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të saj. Detyra e GJEDNJ-së është të shqyrtojë nëse rezultati që KEDNJ-ja kërkon, është arritur nga shtetet kontraktuese. Veçanërisht, mjetet procedurale të ofruara nga legjislativi i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive, kur një person i akuzuar penalisht nuk ka hequr dorë nga të drejtat e tij për t'u dëgjuar dhe mbrojtur personalisht dhe as nuk i është fshehur drejtësisë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.6.2010*).

18. Gjithsesi, jo vetëm shkronja, por as dhe fryma e nenit 6 të KEDNJ-së, nuk e ndalojnë një person të heqë dorë nga të drejtat e tij, me dëshirë shprehimisht ose taktikisht. Por, megjithatë, për qëllimet e KEDNJ-së do konsiderohet efektive, që të drejtat e atij që ka hequr dorë prej tyre, të sanksionohen pa ekuivoqe dhe të shoqërohen me një minimum të garancive, për shkak të rëndësisë së tyre. Autoritetet kombëtare kanë një marzh vlerësimi për zgjedhjen e mjeteve në sistemet e tyre ligjore, por me kusht që këto mjete juridike të jenë në përputhje me standardet e vendosura nga neni 6/1 i KEDNJ-së (*Colozza kundër Italisë, 1985*).

19. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja është shprehur se “ ... njoftimi i të akuzuarit në lidhje me akuzat në ngarkim të tij përbën një akt të një rëndësie të tillë, ku duhet të ekzistojnë elemente të formës dhe përmbajtjes që të garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes nga i akuzuari ... për rrjedhojë një njohuri e pasaktë dhe e marrë nga burime jozyrtare nuk është e mjaftueshme” (*Somogyi kundër Italisë, 18.05.2004*).

20. Në rastin objekt shqyrtimi kërkuesi pretendon se nuk ka pasur dijeni se ndaj tij ishte filluar një çështje penale, pasi njoftimet e kryera nga gjykata janë bërë në adresa të gabuara dhe se adresa e tij ka qenë dhe është një banesë e ndryshme nga ajo në të cilën gjykatat kanë bërë njoftimet.

21. Njoftimi i të pandehurit, në legjislacionin shqiptar, rregullohet nga nenet 132 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Sipas këtyre dispozitave, kur kopja e aktit nuk mund t'i dorëzohet personalisht të pandehurit, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të pandehurin, një fqinji, ose një personi që punon me të (neni 140 i Kodit të Procedurës Penale).

22. Nga materialet bashkëngjitur dosjes gjyqësore vërehet se njoftimet janë bërë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, si në adresën (Lagjja nr.4, rr. Skënderbeu, Durrës) e deklaruar nga bashkëshortja e kërkuesit në prokurën e posaçme me nr.566 Rep., nr.213 Kol., datë 15.12.2005, ashtu edhe në adresa të tjera të identifikuar nga verifikimet e bëra nga organet shtetërore të ngarkuara për kërkimin e kërkuesit. Gjithashtu rezulton se fletëthirrjet e gjykatave, drejtuar kërkuesit, janë marrë ose nga avokati i tij (fletëthirrja e datës 2.6.2006) ose nga vëllai i tij Bedri Sina (fletë thirrja e datës 19.7.2006). Duke vlerësuar personat marrës të fletëthirrjeve, si persona madhorë dhe me aftësi të dukshme intelektuale, si dhe formën e përmbajtjen e fletëthirrjeve, nuk rezulton se ka pasur ndonjë të metë që mund të bënte të pavlefshëm njoftimin në kuptim të neneve 140 dhe 143 të Kodit të Procedurës Penale.

23. Vlen gjithashtu të theksohet se nga korrespondenca ndërmjet gjykatave të të dyja niveleve dhe organeve të Policisë së Shtetit, rezulton se nga këta të fundit kërkuesi është kërkuar jo vetëm pranë adresave të lartpërmendura, por edhe në vende të tjera, në bazë të informacioneve dhe verifikimeve të kryera nga punonjësit e Policisë së Qarkut, gjithmonë pa sukses. Këto organe kanë njoftuar zyrtarisht Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe atë të Apelit Durrës, se nga kërkimet e kryera kanë informacion se kërkuesi është larguar familjarisht nga Republika e Shqipërisë (shih shkresën nr.3194/1 prot., datë 13.7.2006 të Komisarariatit të Policisë Durrës).

24. Sa më lart, Gjykata çmon se organet shtetërore kanë marrë të gjitha masat dhe kanë kryer të gjitha veprimet e mundshme, duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara nga legjislacioni procedural penal, si dhe nga KEDNJ-ja në lidhje me njoftimin personalisht të kërkuesit.

25. Gjykata vëren gjithashtu se nga dokumentet bashkëngjitur dosjes gjyqësore, rezulton se bashkëshortja e kërkuesit (Fiqirete Sina) me anë të prokurës së posaçme me nr.566 Rep., nr.213 Kol., datë 15.12.2005, ka autorizuar avokatin GJ.B. të përfaqësojë gjatë hetimit dhe gjykimit bashkëshortin e saj Ilir Sina, i akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.

26. Nga pyetjet drejtuar mbrojtësit të kërkuesit në seancë plenare, Gjykata krijoi bindjen se kërkuesi Ilir Sina ka pasur dhe vazhdon të ketë marrëdhënie të mira me bashkëshorten dhe se kjo e fundit ka vepruar gjatë redaktimit të prokurës sipas porosisë të kërkuesit (shih procesverbalin e seancës plenare datë 30.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

27. Nga analiza e fakteve të mësipërme, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij dhe së bashku me bashkëshorten e tij, pas redaktimit të prokurës nga kjo e fundit, janë larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur gjithashtu me vullnet të lirë të mos marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij, me qëllim për t'iu fshehur drejtësisë.

28. Duke pasur parasysh se neni 33 i Kushtetutës sanksionon se nuk mund të përfitojë nga e drejta kushtetuese për t'u dëgjuar nga gjykata personi që i fshihet drejtësisë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të gjykimit në mungesë, është i pabazuar.

B. Në lidhje me pretendimin se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë keqinterpretuar ligjin material dhe argumentet e paraqitura nga kërkuesi

29. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se vendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit janë rrjedhojë e interpretimit të gabuar të fakteve dhe zbatimit të keq të ligjit material penal, pasi në rastin konkret ka munguar ana subjektive e veprës penale. Rrjedhimisht, kërkuesi pretendon

se gjendemi përpara një rrethane të përmbushjes së një detyrimi kontraktor civil dhe sipas nenit 1 të Protokollit 4 të KEDNJ-së askujt nuk mund t'i hiqet liria për arsyen e vetme se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

30. Për sa i përket mënyrës se si janë interpretuar dhe vlerësuar provat nga gjykatat e zakonshme, kjo çështje nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese, sepse kjo Gjykatë mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, por jo për mënyrën e vlerësimit. Gjykata Kushtetuese ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit në sferën e gjykimit të saj nuk përfshihet mënyra e zbatimit të ligjit material dhe e vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.23, datë 17.5.2010*).

31. Përfundimisht, Gjykata arrin në konkluzionin se gjatë gjykimit të çështjes në ngarkim të kërkuesit Ilir Sina nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, atij nuk i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj.

Anëtar kundër: Petrit Pllaçi.

VENDIM

Nr.4, datë 30.5.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Gani Dizdari	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Evelina Qirjako	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Majlinda Andrea	Anëtare
Medi Bici	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar,

në seancën gjyqësore të datës 30.5.2011, me pjesëmarrjen e sekretares gjyqësore Brunilda Ago, morën në shqyrtim çështjen civile nr.31001-00012-00-2011, me palë:
6408

PADITËS: Shoqëria tregëtare “Fisheku” sh.a. (në mungesë).

TË PADITUR: 1. Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, përfaqësuar në gjyq nga juristja Ogerta Hoxha dhe avokati i shtetit Abaz Deda.

2. Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, përfaqësuar në gjyq nga avokati i shtetit Abaz Deda.

ME OBJEKT: Shfuqizimi i aktit administrativ “Njoftim-vlerësimi” për detyrimet nr.23702/5 prot., datë 26.11.2009.

Shfuqizimi i vendimit nr.1113, datë 10.3.2010, i Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

ME BAZË LIGJORE: Nenet 31, 32/1, shkronja “a”, 324 të Kodit të Procedurës Civile.

Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Nenet 116, 118 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.2, datë 25.1.2011 ka vendosur: Kalimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, për unifikimin e praktikës gjyqësore.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e gjyqtarëve Aleksandër Muskaj dhe Ardian Nuni, përfaqësuesen e palës së paditur juristen Ogerta Hoxha, e cila kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr.8115, datë 1.11.2010, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, avokatin e shtetit Abaz Deda, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr.8115, datë 1.11.2010, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si dhe pasi shqyrtuan dhe diskutuan çështjen në tërësi, në mungesë të palës paditëse,

VËREJNË:

1. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.2, datë 25.1.2011 ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për unifikim të praktikës gjyqësore, për t’u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve:

a) A janë kamatëvonesat pjesë e detyrimit tatimor, në kuptim të pikës 1 të nenit 107 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”?

b) Nëse kamatëvonesat janë pjesë e detyrimit tatimor, duhet të jenë të përcaktuara në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore, apo tatimpaguesi duhet t’i llogarisë vetë ato dhe t’i paguajë, pavarësisht nëse njoftim-vlerësimi tatimor i përmban si detyrim apo jo?

A. Në lidhje me faktet

2. Pala paditëse, shoqëria tregëtare “Fisheku” sh.a., është shoqëri anonime, me seli në Tiranë dhe ushtron aktivitet tregtar, me objekt “shitje me shumicë të karburanteve”. Shoqëria është regjistruar në regjistrin e shoqërive tregëtare, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.22035, datë 29.9.1999.

3. Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, e thirrur në gjykim në cilësinë e palës së paditur, gjatë kontrollit të ushtruar në dokumentacionin e shoqërisë ka konstatuar dhe ka njoftuar palën paditëse, për detyrime të papaguara.

Me njoftim-vlerësimin për detyrimet nr.23702/5 prot., datë 26.11.2009, pala paditëse është detyruar të paguajë shumën 5.449.872 lekë, si detyrim që buron nga tatimi, kamatëvonesat dhe gjobat, të krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar për vitet 2008 dhe 2009.

4. Pala paditëse e ka kundërshtuar njoftim-vlerësimin nr.23702/5, datë 26.11.2009, përpara Drejtorisë së Apelit Tatimor, Tiranë.

Drejtoria e Apelit Tatimor, Tiranë, me njoftimin nr.15200/1 prot., datë 11.1.2010, ka kërkuar nga pala paditëse plotësimin e dokumentacionit, që i bashkëlidhej ankimit administrativ, brenda 15 ditëve.

Pas plotësimit të dokumentacionit të vlerësuar prej saj, pala paditëse ka paraqitur përsëri ankimin administrativ, kundër njoftim-vlerësimit, datë 26.11.2009.

Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë me vendimin nr.1113, datë 10.3.2010, ka vendosur *“refuzimin e ankimit, për shkak se e konsideron ankimin të papranueshëm, pasi nuk është kryer pagesa e detyrimit tatimor (kamatëvonesat), në shumën 149.835 lekë”*.

5. Pala paditëse i është drejtuar gjykatës dhe ka kërkuar *“shfuqizimin e aktit administrativ njoftim-vlerësimit për detyrimet, nr.23702/5 prot., datë 26.11.2009”*, të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, si dhe të vendimit nr.1113, datë 10.3.2010 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

B. Procedurat gjyqësore

6. Në seancën gjyqësore të datës 22.10.2010, Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, duke pretenduar se nga ana e palës paditëse nuk është konsumuar rekursi administrativ (ankimi i palës paditëse nuk është shqyrtuar nga Drejtoria e Apelit Tatimor, për shkak të mosparapagimit të detyrimit), ka kërkuar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

7. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendim të ndërmjetëm nr.8115, datë 01.11.2010, ka vendosur: *“Të nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështjen civile me nr.8139 Akti, me palë paditëse Shoqëria “Fisheku” sh.a., Tiranë dhe të paditur Drejtoria Rajonale e Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë, DAT pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me objekt: Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim-vlerësimin për detyrimet nr.23703/5 prot., datë 26.11.2009 dhe vendimit nr.1113, datë 10.3.2010, i Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ...”*.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë është bazuar në nenin 59 të Kodit të Procedurës Civile. Në vendimin e saj i është referuar nenit 107 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe udhëzimit nr.24, datë 2.9.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë”*.

Gjykata, duke cituar vendimin nr.3, datë 10.1.2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka përsëritur se: *“...nëse gjykatës i rezulton se ankimi administrativ është paraqitur jashtë afatit dhe/ose mungojnë dokumentet shoqëruese, sipas nenit 55 të ligjit dhe, është shkak i mosshqyrtimit në themel të ankimit, nga organi administrativ, gjykata vendos konform neneve 36 e 59 të Kodit të Procedurës Civile, nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor...”*.

8. Kundër vendimit ka bërë ankim të veçantë shoqëria “Fisheku” sh.a., duke kërkuar prishjen e vendimit nr.8115, datë 1.11.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit.

Pala e paditur në ankimin e paraqitur ka pretenduar këto shkaqe:

“Shoqëria Anonime “Fisheku” i ka paguar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga njoftim-vlerësimi i kundërshtuar gjyqësisht.

Neni 107 i ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, si dhe udhëzimi i Ministrisë së Financave nuk parashikojnë të bëhet parapagim për interesat apo kamatëvonesat, pasi ligji përcakton qartë se parapaguhet vetëm detyrimi.

Njoftim-vlerësimi nuk përmban asnjë detyrim në lidhje me interesat apo kamatëvonesat.

Gjykata Kushtetuese ka konsoliduar praktikën në lidhje me kushtëzimet e vendosura nga administrata publike, të cilat përbëjnë një kufizim joproporcional, ndërhyrje të pajustificuar, në të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Kjo gjykatë e konsideron të tepërt dhe jo në proporcion të drejtë me parimin e “interesit publik”, kushtëzimet e natyrës pasurore (gjoha, interesa), të cilat cenojnë drejtpërdrejtë aksesin në gjykatë të subjekteve tatimore (vendimi nr.18 datë 23.4.2008).

Edhe legjislati i vjetër tatimor, tashmë i ndryshuar, ligji 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” parashikonte se: “Para se të paraqiten për apelim në shkallët e apelit administrativ, tatimpaguesit janë të detyruar të parapagujnë detyrimin tatimor, pa përfshirë interesat dhe gjohat që lidhen me këtë detyrim”.

Për sa sipër humbet kuptimin interpretimi i palës së paditur dhe i gjykatës, i bazuar në nenin 6 “Detyrimi tatimor” pika 3 e ligjit të sipërcituar.”

C. Vlerësimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

9. Vlerësimi ligjor i rrethanave të faktit, nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, do të shërbejë jo vetëm për vlerësimin e zgjidhjes së çështjes konkrete, por edhe për unifikimin e qëndrimeve në zbatimin në praktikë të ligjit.

10. Objekti i padisë në gjykim është kundërshtimi i njoftim-vlerësimit tatimor nr.23703/5 prot., datë 26.11.2009 dhe i vendimit nr.1113, datë 10.3.2010, i Drejtorisë së Apelitit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

11. Kundërshtimi i aktit administrativ, njoftim-vlerësimi tatimor, është parashikuar në kreun XIII të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Në nenin 106 të ligjit është parashikuar se cilat akte përbëjnë objekt të kundërshtimit administrativ, forma e ankimit, organi të cilit i drejtohet ankimi, si edhe afati, brenda të cilit duhet të paraqitet ankimi:

“1. Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim-vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin.

2. Ankimi bëhet me shkrim dhe në formën e parashikuar në zbatim të këtij ligji, me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në Drejtorinë e Apelitit Tatimor brenda 30 ditëve kalendarike, nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë, ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.”

Ndërsa, në nenin 107 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligjvënësi ka parashikuar pagesën e detyrueshme të detyrimit tatimor, detyrim i cili është objekt i ankimit:

“ 1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që, bashkë me ankesën, të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

2. Shuma e pagueshme, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton të gjitha gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimit.

3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është subjekt i ankimit.

4. Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ankimit në rrugë administrative, nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore.”

12. Nenet 106 dhe 107 të ligjit material, nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, kushtëzojnë subjektin tatimpagues për vënien në lëvizje të procesit të ankimit kundër aktit administrativ.

Në rastin e kundërshtimit të njoftim-vlerësimit tatimor, subjekti tatimpagues duhet të **paguajë të plotë shumën e detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftim-vlerësimin tatimor.**

Dispozita materiale përmban njëkohësisht edhe ndalimin e organit administrativ të shqyrtojë ankimin në rastet kur, nuk është përmbushur detyrimi i përcaktuar në dy paragrafët e mësipërm, të po kësaj dispozite.

13. Me “detyrim tatimor”, ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6/3 nënkupton **“tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”.**

Dallohet qartësia në ligj që, **për t’u marrë në shqyrtim ankimi detyrimisht duhet që të parapaguhet, sipas aktit administrativ njoftim-vlerësimit, detyrimi tatimor, i cili duhet të ketë të përfshirë tatimin dhe kamatëvonesat.**

Gjobat, megjithëse konsiderohen sipas nenit të cituar, si pjesë e detyrimit tatimor, nuk përfshihen, si pjesë e parapagimit të detyrimit, si një kusht i domosdoshëm, për të marrë në shqyrtim ankimin administrativ.

Përjashtimin e gjobave nga detyrimi tatimor, i cili duhet të paguhet përpara fillimit të ankimit administrativ e ka parashikuar, jo vetëm pika 2, e nenit 107 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Udhëzimi nr.24, datë 2.9.2008 i Ministrisë të Financave ka parashikuar që:

“Shuma e detyrimit për t’u paguar përfshin vetëm shumën e tatimit dhe interesin, nëse ka, në aktin administrativ që ankimohet, që është i pagueshëm në momentin e ankimit, duke përjashtuar gjokat e përfshira në aktin administrativ objekt ankimi.”

Gjithashtu, përjashtimi nga pagimi i gjobave si pjesë përbërëse e detyrimit tatimor është realizuar edhe nga vendimi nr.16, datë 25.7.2008 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e cila e konsideron në kundërshtim me Kushtetutën, detyrimin e biznesit të parapaguajë, si pjesë të detyrimit tatimor edhe gjobën.

14. Zhvillimet e legjislacionit tatimor në Republikën e Shqipërisë kanë ruajtur të njëjtat karakteristika në lidhje me përkufizimin e detyrimit tatimor apo në lidhje me institutin e parapagimit të detyrimit, si kusht për realizimin e ankimit administrativ.

Edhe në vlerësimin e çështjes nga pikëpamja historike, rezulton koherenca me ligjin e mëparshëm, nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore”. Ligjvënësi ka parashikuar si kusht, për paraqitjen e ankimit administrativ, parapagimin e detyrimeve tatimore, të përcaktuara në njoftim-vlerësimin e nxjerrë nga organi administrativ, përkatësisht organi tatimor.

Në harmoni edhe me ligje të tjera materiale tatimore, ndër të cilat ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (nenet 30 dhe 36 të tij), apo dhe të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (nenet 21 dhe 36) dallohet parashikimi i ndalimit të shqyrtimit të ankimit administrativ, pa parapagimin e detyrimit tatimor.

15. Legjislacioni tatimor në Republikën e Shqipërisë, duke qenë instrument i politikës ekonomike e sociale të shtetit, është ndërtuar në përputhje me kërkesat e nenit 155 të Kushtetutës së Republikës, sipas të cilit:

“Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj”.

Qëllimi i vendosjes së këtyre rregullave është garantimi i mbledhjes së tatimeve dhe shmangia e fenomenit negativ të mospagimit të tyre, me rrjedhoja për ekonominë e vendit.

Tatimet dhe taksat janë pjesë e sistemit financiar të shtetit. Buxheti i Shtetit krijohet nga të ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera financiare, si dhe prej të ardhurave të tjera të ligjshme (neni 157 i Kushtetutës). Qëllimi i sistemit tatimor është mirëqenia e përgjithshme, që do të thotë e individëve dhe e komunitetit në përgjithësi, si dhe përmbushja e objektivave sociale të shtetit.

Nenet 155 dhe 157 të Kushtetutës sigurojnë qëndrueshmërinë e sistemit buxhetor, duke përcaktuar burimet e krijimit të të ardhurave të buxhetit të shtetit, midis të tjerave, nëpërmjet detyrimit kushtetues, për të paguar detyrimet tatimore.

Taksat dhe tatimet nuk janë detyrime të negociueshme dhe mbledhen nga organet tatimore me mënyrat e përcaktuara me ligj. Marrëdhëniet e tatim-taksave janë marrëdhënie ligjore detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe si të tilla, ato mund të përcaktohen vetëm me ligj.

17. Pagesa e një sasive të caktuar të hollash, e barsvlefshme me masën e detyrimit tatimor, gjobave dhe interesave, është një shumë e cila merret nga pasuria e tatimpaguesit, rrjedhojë e detyrimit, që tatimpaguesit i buron nga ligji, për pagimin e detyrimeve financiare. Detyrimi për pagimin e tatimeve dhe taksave, apo detyrimeve të tjera financiare, është detyrim i parashikuar nga neni 155 i Kushtetutës, i disiplinuar në ligje dhe akte të tjera nënligjore.

18. Vendosja e parakushtit të pagimit të detyrimit tatimor, përpara fillimit të procedurave të ankimit, nga pikëpamja formale, duket si një kufizim i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut.

E drejta për ankim efektiv nuk përjashton mundësinë e kufizimit të saj, mjafton që të konkurrojnë kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Në këtë kontekst, Kolegjet e Bashkuara gjejnë se ky kufizim i përcaktuar me ligj, nuk cenon thelbin e së drejtës, është në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar dhe nuk tejkalon kufizimet e parashikuara në Konventën europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”. Kufizimi i të drejtës së ankimit për rastet e përmbushjes së detyrimeve fiskale i shërben interesit publik, në përputhje me politikën e shtetit që, kanë të bëjnë me grumbullimin e të ardhurave të ligjshme për shtetin.

19. Në vijim, duket dhe është pretenduar kontradiktë midis bazës ligjore të funksionimit të veprimtarisë administrative mbi taksat e tatimet, me nenin 41 të Kushtetutës së Republikës.

Neni 41 i Kushtetutës së Republikës garanton të drejtën e pronës private dhe njëkohësisht përcakton kriteret për shpronësimin apo kufizimin me ligj, të ushtrimit të kësaj të drejte.

20. I njëjti dyshim vërehet dhe në pajtueshmërinë e këtij legjislacioni, me nenin 1 të Protokollit nr.1, të Konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, i cili garanton në substancë të drejtën e pronës. Në esencë ky nen mbron gëzimin e qetë të pronës, vendos kushte për privimin nga pasuria, si dhe u njeh shteteve të drejtën, midis të tjerave, të kontrollojnë përdorimin e pasurive në pajtim me interesin e përgjithshëm.

Në kundërshtim me dyshimet e krijuara, është pikërisht protokollin nr.1 i Konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, që krijon mundësi për shtetet, në zbatim të parimit të ligjshmërisë, të kenë në fuqi ligje, për të siguruar pagesën e taksave, kontributeve të tjera, ose të gjobave.

21. Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” është parashikuar koncepti “detyrim tatimor”, njëkohësisht është realizuar edhe mundësia e ankimit administrativ.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi analizuan pajtueshmërinë e legjislacionit material të tatim-taksave, me Kushtetutën e Republikës dhe aktet juridike ndërkombëtare, pas analizës dhe interpretimit të normave të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, arrin në vlerësimin unifikues se:

“Tatimi i papaguar dhe kamatëvonesat e krijuara janë pjesë dhe përbëjnë detyrimin tatimor, i cili duhet të paguhet përpara fillimit të procedurave të ankimit administrativ. Mospagimi i tyre përpara paraqitjes së ankimit administrativ, kundër njoftim-vlerësimit, passjell mosshqyrtimin e kërkesës ankimore”.

22. Sipas nenit 76 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, kur tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor brenda afateve të përcaktuara në ligje të veçanta, ai është i detyruar që për periudhën nga afati ligjor deri në datën e pagesës, të paguajë kamatëvonesë.

Masa e kamatëvonesës është 120 për qind e shkallës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, që përcaktohet çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës.

23. Gjithashtu, nëse një rimbursim, i cili duhej kryer nga administrata tatimore, sipas nenit 75 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nuk kryhet brenda 30 ditëve kalendarike, administrata tatimore paguan kamatëvonesë për shumën e paguar më tepër:

a) kur një shumë e paguar më tepër kreditohet kundrejt një detyrimi tatimor tjetër, kamatëvonesa paguhet, duke filluar nga data e pagesës më tepër, deri në afatin e pagesës së tatimit, kundrejt të cilit bëhet kreditimi;

b) kur një shumë e paguar më tepër rimbursohet, kamatëvonesa paguhet për periudhën nga 30 ditë, pas bërjes së pagesës më tepër, deri në kryerjen e rimbursimit.

24. Kamatëvonesat konsiderohen pjesë e pandarë e detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Ato duhet të paguhen në çdo rrethanë dhe nuk mund të hiqen nga administrata tatimore, as të ankimohen, me përjashtim të rasteve kur ka gabime në llogaritje ose kur detyrimi tatimor, për të cilin zbatohen, ndryshon. Kamatëvonesat mblidhen duke respektuar të gjitha procedurat e mbledhjes së tatimeve të papaguara.

25. Përveç kësaj, pagimi i detyrimeve paraqitet si një interes publik për të siguruar që autoriteti financiar tatimor të ushtrojë aktivitet normal, të saktë dhe të përshtatshëm me interesin publik, për qëllime të realizimit të tatim-taksave edhe më tej, të vlerësimit tatimor. Kjo veprimtari është e siguruar nga disa kushte të përcaktuara me ligjet tatimore, dhe është e lidhur me kërcënimin e kamatëvonesave apo gjobave financiare, për rastet e shmangieve nga pagimi i detyrimeve, apo mospagimi në kohë i detyrimeve.

26. Njoftim-vlerësimi tatimor, përfshirë detyrimin e papaguar, kamatëvonesat dhe gjobat, nuk duhet konsideruar vetëm si kërkesë apo urdhërim shlyerje e detyrimit të parashikuar tatimor, nga ana e tatimpaguesit, por edhe si objektivi më i rëndësishëm i masave, në lidhje me pagimin e detyrimeve.

Në mënyrë më të posaçme, objektivi i njoftim-vlerësimit tatimor është që të ushtrojë presion mbi tatimpaguesit për të përmbushur detyrimet e tyre dhe për të ndëshkuar shkeljet që kanë shkaktuar mospërmbushjen e detyrimit.

Në këtë mënyrë, kamatëvonesat dhe gjobat janë “*sanksione parandaluese edhe ndëshkuese*”. (shih “*Ozturn kundër Gjermanisë*” i datës 21 shkurt 1984, seria A Nr 73, f. 18, § 50).

27. Detyrimi tatimor, në veçanti për kamatëvonesat, rezulton të jetë detyrim progresiv. Llogaritja ditë pas dite e tij, nga organi tatimor, do të shkaktonte konfuzion, për rrjedhojë do të rrezikonte seriozisht ekzekutimin e plotë dhe të saktë të detyrimit.

Praktikat e administratës tatimore kanë njohur disa mënyra të vjeljes së detyrimeve që përmbajnë kamatëvonesat, të gjitha me synimin që përmbushja e detyrimit tatimor të jetë sa më efektive për palët, subjektin tatimpagues dhe shtetin.

Mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor që përmban kamatëvonesat, janë rregulluar me akte nënligjore dhe kanë funksionuar në përgjithësi në bazë të praktikave të paqëndrueshme dhe konfliktuale.

Shkak i paqëndrueshmërisë dhe konfliktualitetit ka qenë natyra e detyrimit që përmban kamatëvonesat dhe pas kësaj sjellja administrative e palëve, rrjedhojë e vlerësimeve dhe vullneteve të ndryshme ndaj ekzistencës dhe përmbushjes së detyrimit.

28. Paqartësitë në kuptimin dhe zbatimin e ligjit, në lidhje me ekzekutimin vullnetar apo të detyrueshëm të detyrimit tatimor, janë përcjellë dhe në organet administrative të apelimit, si edhe në ato gjyqësore, duke shkaktuar qëndrime të ndryshme.

29. Është pranuar ndërkohë, nga vullneti dhe sjellja e palëve, subjektet tatimpaguese dhe shteti, parashikimi në ligj dhe në akte të tjera nënligjore, që kamatëvonesat lindin në çastin që duhej të ekzekutohej detyrimi në të holla dhe përfundojnë në çastin e përmbushjes së plotë të tij.

30. Në një marrëdhënie midis subjekteve debitor-kreditor, krijimi, zhvillimi apo ndërprerja e kamatëvonesave varet vetëm nga vullneti dhe sjellja e debitorit për të përmbushur në kohë detyrimin.

Rrjedhojë e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe e aktivitetit dhe dokumentacionit financiar pranë administratës tatimore, jo vetëm prezumohet, por edhe është njohur dhe realizuar në fakt mundësia e subjektit tatimpagues, për të ardhur në dijeni, në çdo kohë, të vlerës së detyrimit tatimor në përgjithësi, si dhe të kamatëvonesave në veçanti.

31. Përcaktimi përfundimtar i kamatëvonesave, në aktin e njoftim-vlerësimit të detyrimit tatimor është i pamundur, për shkak të natyrës së tyre vazhduese. Sipas standardeve të kontabilitetit i vetmi moment në të cilin përlllogaritjet në mënyrë përfundimtare dhe maturohet interesi, kamatëvonesat, është kur paguhet detyrimi.

Në rrethanat kur detyrimi tatimor në përgjithësi është i panegociueshëm, kur ai është i përcaktueshëm në çdo kohë nga subjekti tatimpagues, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në vlerësimin unifikues se:

“Llogaritja dhe pagimi i kamatëvonesave është detyrim vazhdues i subjektit tatimpagues, deri në çastin e përmbushjes së plotë të detyrimit kryesor.”

D. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

32. Pala paditëse “Fisheku” sh.a. ka pretenduar gjatë gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, se ka përmbushur detyrimin ligjor, duke parapaguar shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

Nga pala e paditur është prapësuar se pala paditëse nuk e ka përmbushur plotësisht detyrimin ligjor, nuk ka paguar kamatëvonesat, të cilat janë pjesë e detyrimit tatimor. Të paditurit kanë përdorur si bazë ligjore të prapësimin të tyre pikën 3 të nenit 6 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”:

“Detyrimi tatimor për tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”.

Paditësit kanë pranuar faktin që nuk janë paguar kamatëvonesat, me justifikimin që në aktin e njoftuar nga pala e paditur, në pjesën e kamatëvonesave nuk ishte përcaktuar si detyrim.

33. Pala paditëse “Fisheku” sh.a. përpara së t’i drejtohej me ankim administrativ Drejtorisë së Apelit Tatimor, Tiranë, *“...duhet që, bashkë me ankesën, të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore...”*, duke u përjashtuar të gjitha gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar, në zbatim të pikës 2 të nenit 107 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*.

Jo vetëm kaq por, në pikën 4 të po kësaj dispozite, është përcaktuar se: *“...Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është shqyrtuar nga organi administrativ, nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore.”*

Kërkuesi, para se t’i referohej rrugës gjyqësore për kundërshtimin e akteve të vlerësimit tatimor, nuk ka paguar tërësisht detyrimin, kusht ky për të realizuar ankimin administrativ e atë gjyqësor.

34. Nisur nga rrethanat e faktit të treguara, arritjet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në unifikimin e praktikës gjyqësore, vendimi i ndërmjetëm nr.8115, datë 1.11.2010, i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin është vendosur: *“Nxjerrja jashtë juridiksionit gjyqësor e çështjes civile me nr.8139 Akti, me palë paditëse Shoqëria “Fisheku” sh.a., Tiranë dhe të paditur Drejtorja Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë”, gjendet i drejtë, i bazuar në fakt dhe në ligj, dhe do të lihet në fuqi.*

35. Pretendimet e parashtruara në ankimin e palës paditëse, pasi u verifikuan nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjenden të pabazuara në ligj.

36. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se shkak material i ankimit administrativ dhe kërkesëpadisë së palës paditëse është vendimi i administratës tatimore njoftim-vlerësimi, nëpërmjet të cilit janë vendosur e njoftuar detyrimet tatimore për paditësin.

Kolegjet pajtohen me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, sipas së cilës organet tatimore janë organe administrative dhe veprimtaria e tyre, apo aktet që ato nxjerrin, nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për t’u përfshirë në kriteret dhe kushtet e nenit 6§1 të Konventës europiane *“Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”*.

“Gjykata çmon që Shtetet Kontraktuese duhet të jenë të lira për t’u dhënë autoriteteve tatimore fuqinë të vendosin ndëshkime të tilla si vlerësime në lidhje me taksat, edhe kur ato arrijnë në sasi të mëdha. Ky sistem nuk është në mospërputhje me nenin 6§1, me kusht që tatimpaguesi mund të kundërshtojë çdo lloj vendimi rreth tij, përpara një trupi gjyqësor që ka juridiksion të plotë, duke përfshirë fuqinë për të anuluar në çdo aspekt, të faktit dhe të ligjit, vendimin e kundërshtuar.”

(“Bendenoun kundër Francës” - 24 shkurt 1994, fq 19-20, § 46 dhe “Umlauf pushtet v. Austria e 23 tetor 1995, Seria A nr.328-B, fq 39-40, § § 37-39.)

37. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka përkrahur në mënyrë të vendosur që, në përgjithësi, kundërvajtjet dhe mosmarrëveshjet civile të natyrës fiskale janë jashtë fushëveprimit të *“të drejtave dhe detyrimeve të një natyre civile”* të parashikuar nga neni 6 i Konventës, pavarësisht nga efektet financiare, që ato prodhojnë për tatimpaguesin. *(Ferrazzini kundër Italisë, [GC], n.44759/98, publikuar në ECHR 2001- VII).*

GJEDNJ-ja në vazhdimësi ka përkufizuar konceptin “akuzë penale” në terma të kufizuar dhe të pavarur, me shtrirje brenda situatave juridike të karakterizuara nga tre kriteret: **i)** kualifikimi ligjor i marrëdhënies apo normës juridike, **ii)** natyra e kundërligjshmërisë dhe **iii)** lloji e rëndësia e dënimit. *(shih, ndër vendime të tjera, “Ozturk kundër Gjermanisë”, gjykim i cituar më sipër, §26 dhe “Lauko e Kadubec kundër Sllovakia” 2 shtator 1998, “Reports of Judgements and Decisions” 1998 – VI, pp. 2492 e 2518.)*

38. Marrëdhënia juridike që është bërë shkak për nisjen e procesit gjyqësor midis palëve, nuk është e karakterit penal. Ajo rregullohet nga ligje të ndryshme tatimore. Gjithashtu, janë të përcaktuara dhe organet tatimore dhe administrative, rregullat që duhet të ndiqen në ecurinë dhe rregullimin e këtyre marrëdhënieve. Përfundimisht nuk mund të thuhet që veprimtaria e

administratës tatimore, akt vlerësimi tatimor, përfshirë dhe elemente të tilla, si kamatëvonesa apo gjoba, janë të parashikuara dhe gjejnë rregullim nga legjislati “penal”.

Është e nevojshme që të vlerësohet dhe prania e dy kritereve të tjera, “natyra e kundërligjshmërisë dhe lloji e rëndësia e dënimit”. Këto kritere janë kritere alternative dhe jo kumulative. Kjo do të thotë që, për zbatimin e nenit 6 të Konventës është e mjaftueshme të dallohet nëse vepra është e natyrës penale në këndvështrimin e Konventës, ose për nga natyra dhe shkalla e ashpërsisë, në përgjithësi i përket sferës penale.

Përsa i përket natyrës së sjelljes të paditësit, gjykata vëren se administrata tatimore ka konstatuar detyrime tatimore të papaguara, detyrime të cilat rezultojnë të vendosura në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të cilit i nënshtrohen të gjithë personat përgjegjës për të paguar tatime.

39. Referimi në rekurs, tek vendimet nr.18, datë 23.4.2010 dhe nr.16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese është i gabuar.

Në vendimin nr.16, datë 25.7.2008 Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundimin se: ... *“parapagimi i gjobës, si parakusht për të ngritur padi në gjykatë, është një barrë e tepruar që nuk diktohet nga nevoja e efektivitetit të masave administrative, siç është ajo e vjeljes së gjobave. Për pasojë, duke qenë e tillë, masa e parapagimit të gjobës, si parakusht për realizimin e të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës për kundërshtimin e kësaj mase administrative, përbën një ndërhyrje të palejueshme në të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës”.*

Ndërkohë, në çështjen konkrete, “si parakusht për realizimin e së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës” nuk ka qenë pagimi i gjobës, por pagimi i kamatëvonesave si pjesë e detyrimit tatimor.

40. Në çështjen “Janosevic kundër Suedisë” (vendimi i datës 23 korrik 2002, nr.34619/97.) GJEDNJ-ja ka ritheksuar se: *“Neni 6 § 1 i Konventës parashikon “të drejtën për një proces gjyqësor”, - ku “aksesi në gjykatë” përbën një ndër elementet themelore “të së drejtës, për një gjykim të drejtë. Kjo e drejtë nuk është absolute, por mund të jetë objekt i kufizimeve. Sidoqoftë, këto kufizime nuk duhet të prekin thelbin e së drejtës. Përveç kësaj, kufizimet nuk do të konsiderohen në përputhje me nenin 6 § 1 në qoftë se nuk ndjekin një qëllim të ligjshëm ose, nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur.”* (shih, ndër vendimet e tjera, vendimi Deweer v. Belgjikë 27 shkurt 1980, Seria A nr 35, fq 24-25, § § 48-49, dhe Ishull - Mouhoub kundër Francës të datës 28 tetor 1998, Raportet 1998 - VIII, p.3227, § 52).

41. Në çështjen konkrete, njoftim-vlerësimi, detyrimi tatimor dhe kamatëvonesat, si akte të nxjerra nga administrata tatimore, në bazë të ligjit justifikojnë ndërhyrjen, duke e konsideruar kufizimin në proporcionalitet, me qëllimin për vjeljen e tatim-taksave. Gjykata, përkundër mungesës së vullnetit të paditësve, për të respektuar detyrimet ligjore, nuk gjen asnjë arsye të veçantë, që do t’i mundësonte paditësve aksesin e drejtpërdrejtë në gjykatë.

“Vetëm nëse ka arsye të veçanta, ankesa mund të referohet drejtpërdrejtë në gjykatë. Në një rast normal, rishikimi nga autoriteti tatimor është një kusht për shqyrtimin e ankimit nga Gjykata.” (Janosevic kundër Suedisë).

42. Rezulton që gjykata e shkallës së parë të ketë respektuar parimet e së drejtës, duke u bazuar, veç të tjerave dhe në vlerësimet unifikuese të vendimit nr.3, datë 10.1.2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendim që i ka paraprirë përfundimeve të Gjykatës Kushtetuese, pikërisht në vendimin të cilit i referohen ankuesit:

“Kushti i proporcionalitetit të ndërhyrjes, me gjendjen që e ka diktuar atë (ndërhyrjen), imponon ligjvënësin të aplikojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen.” (vendim nr.16, datë 25.7.2008 i Gjykatës Kushtetuese)

“Gjykata e nxjerr çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor vetëm kur paditësi, për faj të tij, nuk e ka paraqitur ankimin administrativ në afat ose nuk ka kompletuar dokumentet shoqëruese sipas ligjit (megjithëse organi administrativ e ka vënë në dijeni për të metat e ankimit.” (vendim nr.3, datë 10.1.2008, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, si dhe neneve 59, 481 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

Lënien në fuqi të vendimit nr.8115, datë 1.11.2010, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Shpresa Beçaj (kryesuese), Aleksandër Muskaj, Ardian Nuni, Evelina Qirjako, Ardian Dvorani, Gani Dizdari, Majlinda Andrea, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Guxim Zenelaj, Andi Çeliku, Medi Bici.

VENDIM

Nr.62, datë 14.9.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 57, 58, 61 dhe 68 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për administrimin e rrezikut të kredisë” dhe anekset e saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.52, datë 14.7.2004, e ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**KRYETARI
Ardian Fullani**

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË NGA BANKAT DHE DEGËT E
BANKAVE TË HUAJA

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është:

- a) përcaktimi i rregullave për administrimin e rrezikut të kredisë në veprimtarinë e bankave dhe degëve të bankave të huaja; dhe
- b) përcaktimi i kritereve për vlerësimin e rrezikut dhe klasifikimin e kredive dhe aktiveve të tjera, si dhe llogaritjen e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi i tyre.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) neneve 57, 58, 61 dhe 68 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet “Ligji për bankat”.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, të cilat këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhen me termin e përbashkët “banka”.

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “Aktive të tjera” janë aktivet financiare brenda dhe jashtë bilancit (duke përjashtuar kreditë), të cilat sipas standardeve kontabël, mbahen me koston e amortizuar;

b) “Standardet kontabël” janë standardet kontabël të hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare, të cilat sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, zbatohen nga bankat për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare;

c) “Kredimarrës i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit” është kredimarrësi që përfiton kredi në valutë (monedhë të huaj) dhe/ose të indeksuar në valutë (monedhë të huaj) nga banka, dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

i) të ardhurat e tij në origjinë gjenerohen në monedhë vendase ose në një monedhë të ndryshme nga monedha e përfitimit të kredisë,

ii) të ardhurat e tij në valutë (monedhë të huaj) mbulojnë më pak se 80% (tetëdhjetë për qind) të këstit të kredisë ose të kredisë në total (kryegjë dhe interes, në varësi të periudhës së llogaritjes) dhe detyrimeve të tjera në monedhë të huaj ose të indeksuara në valutë,

iii) nuk është i mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit nëpërmjet një produkti derivativ (instrumente derivative), që përdoret për këtë qëllim dhe që ofron kushte të përshtatshme mbrojtjeje.

d) “Stress-testing” është teknikë e administrimit të rrezikut të kredisë e përdorur për të vlerësuar ndikimin e ndryshimit të mundshëm të një ose më shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm mbi qëndrueshmërinë financiare të bankës;

e) “Ristrukturimi i kredisë” është lehtësimi/et që banka bën për kredimarrësin/it për shkak të vështirësive financiare të tyre të shkaktuara nga arsye ekonomike ose ligjore, të cilat nuk bëhen nga banka në asnjë rast tjetër dhe përfshijnë në përgjithësi:

i) lehtësimet e bëra në kushtet e kredisë nëpërmjet ndryshimit të një ose disa kushteve të kontratës (duke përfshirë ndryshimin e produktit dhe kapitalizimin e interesit), të cilat lidhen kryesisht me afatin, kryegjënë dhe normën e interesit,

ii) marrjen (përdorimin) e kolateralit apo pasurive të tjera për shlyerjen e pjeshme të kredisë,

iii) zëvendësimin e kredimarrësit fillestar ose përfshirjen e një kredimarrësi shtesë;

f) “Vështirësi financiare të kredimarrësit” janë përkeqësimet e gjendjes financiare të kredimarrësit, të cilat mund të sjellin vonesa në pagesat e kredisë ose klasifikimin e kredisë si kredi me probleme;

g) “Kredi me probleme” janë kreditë e klasifikuara në tre kategoritë e fundit të klasifikimit të kredive. Shuma bruto (kryegjë + interes) e tyre përbën totalin e kredive me probleme;

h) “Kapitalizimi i interesit” është procesi përmes të cilit interesi i përlllogaritur i shtohet kryegjësë;

i) “Zbutja e rrezikut të kredisë” është një teknikë e përdorur nga banka për të zvogëluar rrezikun e kredisë/ve të saj, nëpërmjet përdorimit të një garancie ose kolaterali;

j) “Kolateral” është aktivi që përdoret për të siguruar ekzekutimin e detyrimit ndaj bankës, në rastin kur kredimarrësi nuk paguan kredinë sipas kushteve dhe afateve të kontratës;

k) “Garanci” është angazhimi, i shprehur në mënyrë të shkruar nga një palë e tretë, për të paguar kredinë brenda një afati të caktuar, në rastin kur kredimarrësi nuk paguan sipas kushteve dhe afateve të kontratës;

l) “Maturiteti i mbrojtjes së kredisë” është koha deri në datën më të afërt në të cilën marrëveshja e garancisë ose lënia si kolateral mund të përfundojë;

m) “Vlerësuesi i pavarur” është personi, i pajisur me licencën përkatëse ose certifikatën për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, i cili është i pavarur nga procesi i vendimmarrjes në dhënien e kredisë;

n) “Plani i emergjencës” është një dokument i hartuar nga banka, në të cilin pasqyrohen rregullat dhe procedurat që duhen zbatuar në kushte jo të zakonshme.

KREU II

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË

Neni 5

Sistemi i administrimit të rrezikut të kredisë

1. Bankat krijojnë dhe zhvillojnë sistemin për administrimin e rrezikut të kredisë, të përshtatshëm me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarive të tyre financiare.

2. Sistemi i administrimit të rrezikut të kredisë është tërësia e politikave, procedurave, rregullave dhe strukturave të bankës, që shërbejnë për administrimin e rrezikut të kredisë.

3. Sistemi i administrimit të rrezikut të kredisë duhet të sigurojë në vazhdimësi vlerësimin në kohë të cilësisë së kredive dhe aktiveve të tjera, duke përcaktuar njëkohësisht fondet rezervë për mbulimin e humbjeve të lidhura me këtë lloj rreziku.

Neni 6
Struktura organizative

1. Banka krijon një strukturë të përshtatshme organizative për administrimin e rrezikut të kredisë, duke përcaktuar qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese.

2. Banka siguron që funksioni i shitjes të kredive, të jetë i ndarë qartë nga pikëpamja organizative dhe operacionale, nga funksionet mbështetëse operacionale dhe ato të kontrollit të rrezikut të kredisë, deri në nivelet më të larta drejtuese.

3. Banka siguron strukturat e duhura për vlerësimin, matjen dhe kontrollin e rrezikut të kredisë, lidhur me përqendrimin sipas sektorëve, sipas gjeografisë/vendeve, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.

Neni 7
Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues i bankës ose organi kompetent i bankës mëmë për degën e bankës së huaj, për qëllime të administrimit të rrezikut të kredisë, është përgjegjës për:

a) miratimin e strategjisë dhe politikave për administrimin e rrezikut të kredisë, si dhe mbikëqyrjen (monitorimin) e zbatimit të tyre;

b) shqyrtimin e përshtatshmërisë së strategjisë dhe politikave të zbatuara, të paktën çdo vit, si dhe në çdo rast që paraqiten zhvillime të rëndësishme që ndikojnë në veprimtarinë e bankës;

c) monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit të kontrollit të brendshëm, si pjesë përbërëse e sistemit të administrimit të rrezikut të kredisë;

d) miratimin dhe shqyrtimin (rishikimin) e rregullt të kufijve të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë;

e) shqyrtimin dhe analizën e raporteve të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë dhe monitorimin e veprimeve të ndërmarra për administrimin e rrezikut të kredisë;

f) shqyrtimin e rezultateve nga stress test-et, të paktën çdo 6 (gjashtë) muaj, me qëllim:

i) përmirësimin e strategjive dhe politikave të administrimit të rrezikut të kredisë,

ii) hartimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullativ të nevojshëm për zgjidhjen e çështjeve kryesore lidhur me ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë,

iii) parashikimin në kohën e duhur të kërkesave për rritjen e kapitalit dhe identifikimin e rrugëve më efektive për vënien në dispozicion të tij,

iv) zhvillimin e planeve efektive të emergjencës;

g) përcaktimin e përjashtimeve të mundshme nga kufijtë e vendosur të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë dhe delegimin e përgjegjësive për marrjen e vendimeve për zbatimin e këtyre përjashtimeve;

h) rishikimin e përshtatshmërisë së strukturave dhe adresimin e mosfunksionimit të tyre ose të përshtatjes me situatat e reja të paraqitura.

2. Këshilli drejtues siguron që sistemi për administrimin e rrezikut të kredisë është subjekt i një procesi efektiv dhe gjithëpërfshirës kontrolli të brendshëm.

Neni 8
Përgjegjësitë e Drejtorisë

1. Drejtorja e bankës është përgjegjëse për zbatimin e strategjisë dhe politikave për administrimin e rrezikut të kredisë, të miratuara nga Këshilli Drejtues ose nga organi përkatës i bankës mëmë.

2. Drejtorja e bankës, në kuadër të administrimit të rrezikut të kredisë është përgjegjëse për:

a) detajimin dhe zbatimin e procedurave për administrimin e rrezikut të kredisë të përshtatshme dhe në përputhje me politikat e miratuara nga Këshilli Drejtues ose organi përkatës i bankës mëmë;

b) krijimin e një sistemi efektiv të matjes, monitorimit, kontrollit dhe raportimit të rrezikut të kredisë, sipas llojit të ekspozimit;

c) ndërtimin e një sistemi të përshtatshëm raportimi përpara Këshillit Drejtues ose organit përkatës të bankës mëmë, mbi shkeljet e kufijve të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë;

d) krijimin e procedurave për matjen e efekteve që produktet e reja mund të kenë në ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë, si dhe monitorimin e detyrimeve dhe ekspozimeve të mundshme, bazuar në aktivitetet jashtë bilancit të bankës, duke përfshirë edhe ekspozimin ndaj rrezikut të kundërpartisë.

Neni 9

Aktet e brendshme

1. Bankat hartojnë strategjinë, politikat, procedurat dhe rregullat e brendshme për monitorimin dhe kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredisë dhe të aktiveve të tjera.

2. Aktet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni përmbajnë/përfshijnë të paktën:

a) strategjinë e kreditimit sipas periudhave, duke përfshirë objektiva realiste në lidhje me zgjerimin e portofolit të kredisë, përbërjen e tij sipas sektorëve, sipas gjeografisë/vendeve, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.;

b) politikat e normave të interesit, të afateve, të shlyerjeve dhe të madhësisë e të llojit të kredive;

c) rregullat dhe kriteret e vendosura për njohjen dhe analizën financiare të kredimarrësit dhe/ose të garantuesit të kredisë;

d) procedurat për dokumentacionin e nevojshëm që duhet plotësuar për dhënien e kredive, si edhe për miratimin e kredisë, sipas hierarkisë së strukturave;

e) politikat e administrimit të rrezikut për të gjithë portofolin dhe për çdo klient në veçanti, kufijtë e kredisë sipas llojeve të kredimarrësve, sipas sektorëve, monitorimin sipas objektit dhe llojit të kredisë, etj.;

f) metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të cilësisë së kredive dhe të krijimit të fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi i kredive;

g) metodologjinë për vlerësimin, matjen dhe kontrollin e rrezikut të kredisë, lidhur me përqendrimin sipas sektorëve, sipas gjeografisë/vendeve, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.;

h) kriteret për ristrukturimin e kredive;

i) procedurat për vlerësimin e cilësisë së aktiveve të tjera dhe për llogaritjen e fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga zhvlerësimi i këtyre aktiveve;

j) procedurën për verifikimin e vlerësimit të kolateralit “pasuri e paluajtshme”, të kryer nga një vlerësues i pavarur;

k) procedurat për monitorimin dhe vlerësimin periodik të kolateralit financiar;

l) procedurat për monitorimin periodik të garancive.

3. Bankat regjistrojnë dhe ruajnë të gjithë dokumentacionin përkatës për kreditë dhe aktivet e tjera.

Neni 10

Stress testing

1. Bankat, nëpërmjet zhvillimit të stress test-eve, vlerësojnë në vazhdimësi dhe në mënyrë të mjaftueshme ekspozimin e tyre ndaj rrezikut të kredisë, duke marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme në të ardhmen të faktorëve të rrezikut që ndikojnë në cilësinë e portofolit të kredive dhe gjendjen financiare të bankës, të materializuara në të ardhurat neto dhe në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

2. Periodiciteti me të cilin bankat kryejnë stress test-et, si dhe raportimi i rezultateve në strukturat drejtuese, përcaktohet prej tyre në përputhje me madhësinë e veprimtarisë, ekspozimin

ndaj rrezikut të kredisë dhe peshën e tyre në sistemin bankar, me kusht që ky periodicitet të mos jetë më pak se 2 (dy) herë në vit. Banka e Shqipërisë mund t'i kërkojë në çdo rast bankës kryerjen e stress test-eve në periudha më të shpeshta dhe/ose sipas skenarëve me supozime të përcaktuara.

3. Stress test-et e realizuara nga banka përfshijnë të paktën përdorimin e skenarëve të veçantë dhe/ose të kombinuar, bazuar në faktorë të tillë si: rënia ekonomike, ndryshimi i shpejtë i kushteve të tregut (ndryshe rreziku i tregut i përcaktuar nga luhatjet në kursin e këmbimit, normat e interesit etj.) me ndikim negativ në ndryshimin e aftësive për pagimin e rregullt të detyrimit (borxhit), apo edhe të skenarëve të një përkeqësimi të portofolit të kredive, pavarësisht nga përcaktimi i faktorit të rrezikut që mund të shërbejë si shkak për materializimin e një situate të pafavorshme.

4. Bankat përcaktojnë metodologjinë për realizimin e stress test-eve, supozimet e përdorura, si dhe veprimet në kundërpërgjigje të rezultateve të gjeneruara, ku përfshihen:

- a) zbatimi, analiza e skenarëve të stress test-eve dhe periodiciteti i realizimit të tyre;
- b) realizimi i stress test-eve për skenarë individualë dhe skenarë të kombinuar, në kushtet e ndodhjes së njëkohshme të disa skenarëve;
- c) dokumentimi dhe rishikimi në mënyrë periodike i supozimeve të përdorura për kryerjen e stress test-eve;
- d) forma dhe periodiciteti i raportimit të rezultateve të stress test-eve në strukturat drejtuese;
- e) veprimet që duhet të ndërmerren nga strukturat drejtuese apo/dhe strukturat e veçanta të ngarkuara për administrimin e rrezikut të kredisë, mbështetur në rezultatet e stress test-eve.

KREU III VLERËSIMI I KREDIVE DHE KRIJIMI I FONDEVE REZERVË PËR MBULIMIN E HUMBJEVE

Neni 11

Klasifikimi i kredive

1. Bankat, bazuar në kushtet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, bëjnë klasifikimin e kredisë të paktën një herë në 3 (tre) muaj, në një nga kategoritë e mëposhtme:

- a) “standarde”;
- b) “në ndjekje”;
- c) “nënstandarde”;
- d) “të dyshimta”;
- e) “të humbura”.

2. Bankat, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë dhe gjendjen financiare të kredimarrësit, i klasifikojnë kreditë (duke përjashtuar kreditë kufi) si më poshtë:

- a) “standarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - i) gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset e pritshme hyrëse të parasë janë plotësisht të mjaftueshme për vazhdimësinë e veprimtarisë së tij dhe shlyerjen e detyrimeve,
 - ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pagesës së kështit;
- b) “në ndjekje”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - i) gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset hyrëse të parasë janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht vështirësive financiare të momentit, dhe se nuk ka shenja përkeqësimi të gjendjes së kredimarrësit për të ardhmen,
 - ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së kështit;
- c) “nënstandarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e rregullt të detyrimeve të prapambetura, ose banka nuk disponon gjithë informacionin e kërkuar ose të përditësuar, të nevojshëm për të vlerësuar plotësisht gjendjen financiare të tij,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

d) “të dyshimta”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e plotë të detyrimeve, kredimarrësi shfaq probleme likuiditeti, dhe deklarimi i kredimarrësit “në paaftësi paguese/i falimentuar”, vlerësohet si një mundësi reale,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 181 njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

e) “të humbura”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit; ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose banka ka vepruar juridikisht dhe në mënyrë përfundimtare (është marrë vendimi i formës së prerë të gjykatës) për të realizuar procesin e ekzekutimit të kolateralit,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së këstit.

3. Bankat, bëjnë klasifikimin e kredive kufi, si më poshtë:

a) “standarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset e pritshme hyrëse të parasë janë plotësisht të mjaftueshme për vazhdimësinë e veprimtarisë së tij dhe shlyerjen e detyrimeve,

ii) shuma e përdorur e kredisë është më e vogël ose e barabartë me shumën maksimale të miratuar,

iii) kredia është deri në 30 (tridhjetë) ditë vonesë nga afati fillestar i shlyerjes,

b) “në ndjekje”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset hyrëse të parasë janë plotësisht të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht vështirësive financiare të momentit, dhe se nuk ka të shenja përkeqësimi të gjendjes së kredimarrësit për të ardhmen,

ii) shuma maksimale e miratuar e kredisë është tejkualuar për një periudhë nga 31(tridhjetë e një) deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë,

iii) afati përfundimtar i shlyerjes ka kaluar për një periudhë nga 31(tridhjetë e një) deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë,

c) “nënstandarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e rregullt të detyrimeve të prapambetura; ose banka nuk disponon të gjithë informacionin e kërkuar ose të përditësuar, të nevojshëm për të vlerësuar plotësisht gjendjen financiare të tij,

ii) shuma maksimale e miratuar e kredisë është tejkualuar për një periudhë nga 61 (gjashtëdhjetë e një) deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë,

iii) afati përfundimtar i shlyerjes ka kaluar për një periudhë nga 61 (gjashtëdhjetë e një) deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë,

d) “të dyshimta”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e plotë të detyrimeve, kredimarrësi shfaq probleme likuiditeti dhe deklarimi i kredimarrësit si “në paaftësi paguese/i falimentuar”, vlerësohet si një mundësi reale;

ii) shuma maksimale e miratuar e kredisë është tejkualuar për një periudhë nga 91 (nëntëdhjetë e një) deri në 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë;

iii) afati përfundimtar i shlyerjes ka kaluar për një periudhë nga 91 (nëntëdhjetë e një) deri në 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë,

e) “të humbura”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit, ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose banka ka vepruar juridikisht dhe në mënyrë përfundimtare (është marrë vendimi i formës së prerë të gjykatës) për të realizuar procesin e ekzekutimit të kolateralit;

ii) kufiri i miratuar është tejkaluar për një periudhë prej më shumë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh,

iii) afati përfundimtar i shlyerjes së kredisë ka kaluar për një periudhë prej më shumë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh,

4. Pavarësisht sa parashikohet në pikën 3 të këtij neni, bankat nuk mund të klasifikojnë kredinë kufi më lart se:

a) kategoria “në ndjekje”, në rastin kur ka një vëllim qarkullimi, i cili nuk është në përputhje me ciklin e biznesit të parashikuar nga banka në analizën e saj, por shuma e kredisë qarkullon të paktën 1(një) herë në vit;

b) kategoria “nënstandarde”, në rastin kur plotësohet të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

i) qarkullimet në llogari janë të vogla krahasuar me shumën e kredisë së përdorur dhe janë të pamjaftueshme për të justifikuar ecurinë normale të biznesit,

ii) kredia kufi ose një pjesë e rëndësishme e saj është përdorur për qëllime investimi afatgjatë.

5. Në rastin kur kushtet e klasifikimit të kredive, të përcaktuara në pikat 2 ose 3 të këtij neni, plotësohen për kategori të ndryshme të klasifikimit të kredisë, bankat klasifikojnë kredinë në kategorinë më të ulët.

6. Bankat, për persona ose grup personash të lidhur, për të cilët është regjistruar më shumë se një ekspozim, bëjnë klasifikimin e kredive në një kategori të vetme, duke u bazuar në klasifikimin më të ulët ndërmjet klasifikimeve individuale.

7. Bankat, në rastin e kredive të klasifikuara në kategoritë “nënstandard”, “të dyshimta” dhe “të humbura”, bëjnë riklasifikimin e një kredie në një kategori më të lartë, vetëm në rastin kur, në bazë të analizave të dokumentuara, rezulton se justifikohet riklasifikimi. Dokumenti i analizës në rastin e riklasifikimit, ruhet në dosjen e kredisë.

8. Banka e Shqipërisë, ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e kategorisë së klasifikimit të kredive, në rastet kur gjykohet se:

a) interpretimi i kushteve të mësipërme nga banka nuk është i drejtë;

b) ka elemente të tjera shtesë, përveç kushteve të mësipërme, që e justifikojnë ndryshimin e kategorisë së klasifikimit.

Neni 12

Gjendja financiare e kredimarrësit

1. Bankat vlerësojnë dhe klasifikojnë kredimarrësit në bazë të gjendjes së tyre financiare.

2. Vlerësimi i gjendjes financiare të një kredimarrësi realizohet sipas kritereve të brendshme të përcaktuara nga banka, mbështetur në procedura të klasifikimit të kredimarrësve në kategori rreziku.

3. Bankat vlerësojnë gjendjen financiare të kredimarrësit sipas kritereve bazuar në të paktën, faktorët cilësorë dhe sasiorë të mëposhtëm:

a) statusi i kredimarrësit, karakteristika personale dhe ekonomike të tij;

b) cilësia e menaxhimit, përfshirë dhe atë të menaxhimit të nivelit të lartë të kredimarrësit, në rastet kur kredimarrësi është person juridik;

- c) cilësia e aksionerëve, cilësia e planeve dhe programeve të mbështetura financiarisht nga banka;
- d) niveli i kapitalit dhe rezervave të kredimarrësit dhe pjesa e tyre në bilancin e kredimarrësit;
- e) cilësia e aktiveve të kredimarrësit;
- f) madhësia e borxhit dhe aftësia për t'i shërbyer, si dhe historiku i ekspozimeve me bankën;
- g) likuiditeti dhe përfitueshmëria;
- h) *cash flow*-t (flukset e parave) e periudhave paraardhëse dhe *cash flow*-t (flukset e parave) e pritshëm, të krahasuar me detyrimet e kredimarrësit;
- i) kushtet e biznesit dhe parashikimet e ardhshme për kredimarrësin, si dhe pozicioni i kredimarrësit në treg dhe në industrinë ku kryen veprimtarinë;
- j) ekspozimi i kredimarrësit ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.
4. Bankat, në vlerësimin e gjendjes financiare të kredimarrësit, mbështeten kryesisht në dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) bilanci (pasqyra e aktiv-pasivit dhe zërave jashtë bilancit);
- b) llogaria fitim-humbje;
- c) vërtetimi i pagës për individët, si dhe deklarata e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre, e dokumentuar për të ardhurat dhe shpenzimet materiale;
- d) pasqyra e detyrimeve mbi kreditë dhe interesat për t'u paguar;
- e) pasqyra mbi ndryshimet në kapital;
- f) pasqyra e *cash flow*-t;
- g) raportet e ekspertit kontabël mbi gjendjen financiare të kredimarrësit;
- h) raporte të agjencive të vlerësimit.
5. Periudhat për të cilat vlerësohet gjendja financiare e kredimarrësit duhet të përputhet të paktën me periudhat e nxjerrjes së pasqyrave financiare.

Neni 13

Ristrukturimi i kredisë

1. Bankat, në marrëveshje me kredimarrësin, mund të ristrukturojnë kredinë, sipas kriterëve të përcaktuara në manualin e kredisë, të miratuar nga organet drejtuese. Ristrukturimi i kredisë mund të kryhet dhe kur, mbështetur në analizat e tyre, bankat gjykojnë se në të ardhmen gjendja financiare e kredimarrësit do të përmirësohet ndjeshëm, ose të ardhurat nga veprimtaria e tij do të rriten në mënyrë të konsiderueshme dhe se kredimarrësi do ta paguajë (shlyejë) të gjithë kredinë sipas kushteve të reja.
2. Kredia e ristrukturuar, nuk mund të klasifikohet më lart se një kategori nga kategoria në të cilën është klasifikuar përpara ristrukturimit dhe, në çdo rast, jo më lart se kategoria “nënstandard”, deri në plotësimin njëkohësisht të kushteve të mëposhtme:
- a) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt këstet (kryegjë dhe interes) për një periudhë prej 9 (nëntë) muajsh nga data e ristrukturimit;
- b) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt të paktën 3 (tre) këste (kryegjë dhe interes).
3. Kredia e ristrukturuar, me plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, klasifikohet duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 14

Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

1. Në varësi të kategorive të klasifikimit, bankat krijojnë fondet përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë.
2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen si më poshtë:
- a) për kategorinë “standarde” 1 (një) për qind;
- b) për kategorinë “në ndjekje” 5 (pesë) për qind;

- c) për kategorinë “nënstandarde”jo më pak se 20 (njëzet) për qind;
- d) për kategorinë “e dyshimtë” jo më pak se 50 (pesëdhjetë) për qind;
- e) për kategorinë “e humbur”100 (njëqind) për qind.

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, për dy kategoritë e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni, do të aplikohet njëllor si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kredinë me probleme, norma e aplikuar mbi interesin e përlllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.

4. Bankat, në llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, mund të përdorin teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë të përcaktuara në Kreun IV të kësaj rregulloreje me qëllim zvogëlimin e ekspozimit përpara aplikimit të normave të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 15

Vlerësimi i kredisë së ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

1. Banka, si pjesë të rëndësishme të strategjisë, të politikave, të procedurave dhe të rregullave të brendshme për monitorimin dhe kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredisë, përfshin në veçanti dhe trajtimin e portofolit/eve të ekspozuara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

2. Banka ponderon me koeficient më të lartë rreziku, për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, vlerën e kredisë në valutë dhe/ose të indeksuar në valutë të ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, siç përcaktohet në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

3. Totali i kredive të bankës në valutë dhe/ose të indeksuara në valutë të ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, nuk duhet të kalojë 400 për qind të kapitalit rregullator të saj në baza individuale dhe të konsoliduara. Çdo shumë që tejkalon këtë kufi do të zbritet nga kapitali rregullator i bankës për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Neni 16

Kontabilizimi i interesave

1. Bankat, për kreditë të cilat janë të pashlyera për më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë, si edhe për kreditë e klasifikuara në kategorinë “të dyshimta” ose në kategorinë “të humbura”, nuk kontabilizojnë interesat e llogaritur.

2. Në rastet kur kredimarrësi shlyen detyrimin, në llogaritjen e detyrimit përfshihen edhe interesat e pakontabilizuara.

Neni 17

Fshirja e kredive të humbura

1. Fshirja e kredive të humbura bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të bankës ose organit kompetent të bankës mëmë, në rastin e degës së bankës së huaj, si dhe në çdo rast kur Banka e Shqipërisë ka vlerësuar dhe kërkuar fshirjen e saj.

2. Dosjet e kredive të fshira, ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj nga Këshilli Drejtues i bankës. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira, konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

KREU IV
TEKNIKAT E ZBUTJES SË RREZIKUT TË KREDISË

Neni 18

Zbutja e rrezikut të kredisë me anë të garancive dhe kolateraleve financiare

Bankat, me qëllim llogaritjen e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, mund të përdorin vlerën e garancive dhe kolateraleve financiare të përcaktuara në këtë rregullore, për të zvogëluar ekspozimin e tyre nga kreditë.

Neni 19

Garancitë e pranuar

1. Bankat, për zbutjen e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë, mund të pranojnë garancitë e përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje, të cilat plotësojnë karakteristikat e mëposhtme:

i) garancia është e lidhur në mënyrë të qartë me ekspozime ose me një portofol ekspozimesh që mund të identifikohen me saktësi, në mënyrë që shkalla e mbulimit të jetë e përcaktuar qartë dhe të mos vihet në dyshim,

ii) kontrata (marrëveshja) e garancisë nuk përmban asnjë dispozitë që mund të lejojë ofruesin e garancisë të anulojë në mënyrë të njëanshme kontratën e garancisë ose të rrisë koston efektive të saj (garancisë),

iii) kontrata e garancisë nuk përmban asnjë dispozitë që përjashton garantuesin nga detyrimi për të paguar brenda afatit të përcaktuar në kontratën e garancisë, në rastin kur kredimarrësi kryesor nuk paguan detyrimin sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratën e kredisë;

2. Garancitë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni do të përdoren për qëllime të zbutjes/zvogëlimit të rrezikut të kredisë, vetëm kur plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) janë ligjërish të sigurta (domethënë, janë përmbushur të gjitha detyrimet/formalitetet ligjore për lëshimin e garancisë) dhe banka disponon dokumentacionin e nevojshëm për ekzekutim;

b) mbulojnë të gjitha llojet e pagesave që kredimarrësi është i detyruar të kryejë, lidhur me detyrimin e tij. Në rastin kur kontrata e garancisë/ve përjashton disa lloje pagesash nga mbulimi, banka, për qëllime të zbatimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, njeh vlerën e garancisë vetëm për shumat që i takojnë llojeve të pagesave që mbulon kjo garanci;

c) banka disponon procedurat dhe sistemet e nevojshme për monitorimin periodik dhe kontrollin e rreziqeve që mund të vijnë nga përdorimi i garancive si teknikë zbutjeje.

Neni 20

Kolateralet financiare

1. Bankat, për zbutjen e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë, marrin në konsideratë kolateralet financiare të përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

2. Kolateralet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, do të përdoren për qëllime të zbutjes/zvogëlimit të rrezikut të kredisë, vetëm kur plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) gjendja financiare e kredimarrësit dhe vlera e kolateralit nuk kanë një lidhje/korrelacion pozitiv material (domethënë, titujt e emtuar nga kredimarrësi ose persona të lidhur me të nuk do të konsiderohen si kolaterale të pranueshme për zbutjen e rrezikut të kredisë);

b) janë ligjërish të sigurta (domethënë, janë përmbushur të gjitha detyrimet ligjore për vendosjen si kolateral) dhe banka ose dega e bankës së huaj disponon dokumentacionin e nevojshëm për ekzekutim;

c) banka disponon procedurat dhe sistemet e nevojshme për monitorimin periodik dhe kontrollin e rreziqeve që mund vijnë nga përdorimi i kolateraleve financiare si teknikë zbutjeje.

3. Bankat llogarisin vlerën e tregut të kolateraleve të pranuar, të paktën një herë në 6 (gjashtë) muaj dhe në çdo rast, kur besojnë se ka një rënie të ndjeshme në vlerën e tregut.

Neni 21

Mënyrat e përdorimit të garancive dhe kolateraleve financiare për zbutjen e rrezikut të kredisë

1. Bankat, për përcaktimin e vlerës me të cilën do të zbusin ekspozimin kundrejt kredimarrësit, korrigjojnë vlerën e garancive të pranura dhe të kolateraleve financiare me koeficientët “K”, të llogaritur sipas formulës së përcaktuar në Aneksin 2, të kësaj rregulloreje.

2. Banka nuk mund të përdorë garancitë dhe kolateraleve financiare për zbutjen e rrezikut të kredisë, në rastin kur:

a) maturiteti i mbetur i mbrojtjes së kredisë është më i vogël se 3 (tre) muaj dhe kredia ka një maturitet të mbetur më të madh se maturiteti i mbetur i mbrojtjes;

b) maturiteti fillestar i mbrojtjes së kredisë është më i vogël se një vit dhe maturiteti i mbetur i kredisë është më i madh se maturiteti fillestar i mbrojtjes.

3. Vlera e koeficientit “K”, në rastin e garancive dhe kolateraleve financiare të lidhura me kreditë e klasifikuara në kategorinë “të humbura” zvogëlohet në masën 50 (pesëdhjetë) për qind të vlerës së llogaritur sipas Aneksit nr.2 të kësaj rregulloreje.

KREU V

VLERËSIMI I AKTIVEVE TË TJERA DHE PËRCAKTIMI I FONDEVE REZERVË PËR MBULIMIN E HUMBJEVE

Neni 22

Vlerësimi i aktiveve të tjera

1. Bankat, të paktën një herë në çdo 3 (tre) muaj dhe në rastet kur ekzistojnë të dhëna që tregojnë se cilësia e çdo aktivi tjetër është përkeqësuar në mënyrë thelbësore, bën rishikimin e vlerësimit të tyre sipas përcaktimeve në standardet e kontabilitetit.

2. Bankat vlerësojnë në mënyrë individuale të gjitha aktivet e tjera, individualisht të rëndësishme.

3. Bankat vlerësojnë pjesën tjetër të aktiveve të tjera, në mënyrë individuale ose në mënyrë kolektive, duke i grupuar sipas karakteristikave të njëjta.

4. Bankat, për evidentimin e aktiveve individualisht të rëndësishme, bazohen në madhësinë relative të tyre ndaj totalit të aktivitetit, të kapitalit rregullator, si dhe në informacionin cilësor si pjesë e një grupi të caktuar aktivesh.

Neni 23

Klasifikimi i aktiveve të tjera dhe përcaktimi i fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve

1. Bankat, bazuar në madhësinë e humbjeve të llogaritura sipas standardeve të kontabilitetit, klasifikojnë aktivet e tjera si më poshtë:

a) “standarde ose të rregullta”, kur madhësia e humbjeve të llogaritura është deri në 5% (pesë për qind) të ekspozimit;

b) “të dyshimta ose me probleme”, kur madhësia e humbjeve të llogaritura është më e madhe se 5% (pesë për qind) e ekspozimit.

2. Bankat krijojnë fonde rezervë për mbulimin në mënyrë të plotë të humbjeve nga zhvlerësimi i aktiveve të tjera.

**KREU VI
RAPORTIMI DHE MBIKËQYRJA**

**Neni 24
Raportimi në Bankën e Shqipërisë**

Bankat raportojnë në Bankën e Shqipërisë klasifikimin e kredive dhe aktiveve të tjera që krijojnë rrezikun e kredisë, si dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin nga humbjet prej tyre, sipas kërkesave të përcaktuara në “Sistemin raportues të unifikuar”.

**NENI 25
Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore**

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat.

**NENI 26
Dispozitë e fundit**

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

**ANEKSI 1
GARANCITË DHE KOLATERALET E PRANUESHME**

Lloji i garancisë ose kolateralit	Koefficienti maksimal (<i>k</i>)
Garancitë	
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose të Bankës së Shqipërisë, në monedhë kombëtare	1
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të qeverive qendrore ose bankave qendrore të vendeve të OECD, ose të Komunitetit European	1
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të bankave shumëpalëshe të zhvillimit ose të Bankës Europiane të Investimeve	0.8
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të organeve të pushtetit vendor të Republikës së Shqipërisë	0.8
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të bankave ose degëve të bankave të huaja, të licencuara për të ushtruar aktivitet në Republikën e Shqipërisë	0.8
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të administratave rajonale ose lokale të vendeve të OECD-së	0.8
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të bankave nga vendet e OECD-së	0.8
Kolaterale financiare	
Tituj të emtuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose nga Banka e Shqipërisë në monedhë kombëtare	1
Tituj të emtuar nga qeveritë qendrore ose bankat qendrore të vendeve të OECD ose të Komunitetit European	1
Depozita monetare të vendosura si kolateral pranë bankës ose degës së bankës së huaj	1
Certifikata depozite ose instrumente të ngjashme, të emtuara nga banka ose dega e bankës së huaj dhe të vendosura si kolateral pranë saj	1
Tituj të emtuar nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit ose nga Banka Europiane e Investimeve	0.8

ANEKSI 2

Llogaritja e koeficientit “K” me të cilin do të korrigojohet vlera e kolateraleve financiare dhe garancive të pranuar.

$$K = (k - k_{FX}) \times \frac{(t - 0.25)}{(T - 0.25)},$$

ku:

(*k*) është koeficienti i përcaktuar në aneksin 1;

(*k_{FX}*) është koeficienti që shërben për korrigjimin e vlerës së garancisë ose kolateralit, për efekt të rrezikut të kursit të këmbimit, i cili:

- në rastin kur garancitë dhe/ose kolaterale financiare janë të emetuara në të njëjtën monedhë me ekspozimin e bankës kundrejt kredimarrësit, merr vlerën 0 (*k_{FX}* = 0), ose

- në rastin kur garancitë dhe/ose kolaterale financiare janë të emetuara në një monedhë të ndryshme, ekspozimi i bankës kundrejt kredimarrësit merr vlerën 0.08 (*k_{FX}* = 0.08);

(*t*) është maturiteti i mbrojtjes së kredisë, i shprehur në vite, i cili është i barabartë me vlerën më të vogël ndërmjet numrit të viteve të mbetura deri në datën e maturimit të mbrojtjes së kredisë dhe vlerës së (*T*);

(*T*) është maturiteti efektiv i kredisë, i shprehur në vite, i cili është i barabartë me vlerën më të vogël ndërmjet numrit të viteve të mbetur deri në datën e maturimit të kredisë dhe vlerës 5 vjet.

VENDIM

Nr.63, datë 14.9.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar; dhe të nenit 59, pika 3 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin nr.58, datë 5.5.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 8, pika 8.1.5, shkronja “a” ndryshon si më poshtë:

“...vlera e kredisë në valutë dhe/ose të indeksuar në valutë për kredimarrësin që plotëson njëkohësisht kushtet e përcaktuara në nenin 4, pika 2, shkronja “c” të rregullores “Për

administrimin e rrezikut të kredisë” dhe karakteristikat e përcaktuara në pikën 8.1.4 shkronja “f”, të kësaj rregulloreje...”

b) Neni 8, pika 8.1.5, shkronja “b” ndryshon si më poshtë:

“...vlera e kredisë së akorduar jashtë territorit ku banka ushtron veprimtarinë nëpërmjet filialeve, degëve ose agjencive të saj...”

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit European dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 18.10.2011
Doli nga shtypi më 21.10.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë